**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

| |
|---|
| **Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti"** <br> **ofruar nga** <br> **Universiteti i Sporteve të Tiranës** |

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**
**Prof.Dr. Bledar Kraja**
**Prof.Asoc. Roland Çerepi**

**Nëntor / 2025**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**
**Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti" ofruar nga Universiteti i Sporteve të Tiranës**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti i Sporteve të Tiranës |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UMAS Nr.48, datë 05.02.2015 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | UMAS nr. 291, datë 23.08.2021 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | VBA Nr. 19, datë 19.02.2021 |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i Dytë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite akademike |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 kredite |
| 11 | Forma e studimit: | Kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 7 I Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 2022-2023 22 PAE / 1 PAK<br>2023-2024 22 PAE / 1 PAK<br>2024-2025 21 PAE / 0 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 2022-2023 16 studentë<br>2023-2024 25 studentë<br>2024-2025 14 studentë |
| 19 | Komente / të tjera: | |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST) është një Institucion publik i Arsimit të Lartë. UST është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 123, datë 17.02.2010. Institucioni është krijuar mbi bazën e Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve "Vojo Kushi", e krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 266, datë 25.05.2000, dhe mbi bazën e Institutit të Lartë të Kulturës Fizike "Vojo Kushi", e krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 394, datë 14.09.1960.

Universiteti i Sporteve të Tiranës është institucion publik i arsimit të lartë, me karakter akademik, shkencor dhe sportiv, me status të veçantë, VKM Nr. 57, datë 29.01.2020. UST, si institucion i arsimit të lartë, zhvillon veprimtari akademike në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor në fushën e edukimit fizik dhe shëndetësor, sporteve, rekreacionit, turizmit sportiv dhe rehabilitimit.

Universiteti i Sporteve të Tiranës përbëhet nga 4 (katër) njësi kryesore dhe 12 (dymbëdhjetë) njësi bazë dhe ofron programe studimi në tri cikle.
Njësitë Kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranës janë:

1) Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes;
2) Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit;
3) Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit;
4) Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit.

Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, ku ofrohet dhe programi i studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", ka në përbërje 3 departamente:

1. Departamenti i Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit;
2. Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit;
3. Departamenti i Menaxhimit të Sportit dhe Turizmit.

Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit (DLSH) është njësia bazë që ofron programin e studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti.
Programi i studimit Master i Shkencave në "Aktivitet Fizik dhe Shëndet" është hapur në vitin akademik 2015-2016, si program studimi i ofruar në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike Rekreacionit, që u krijua me Urdhërin Nr.48, datë 05.02.2015 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Ky program studimi synon përgatitjen e specialistëve me njohuri të përgjithshme në fushën e veprimtarisë fizike dhe shëndetit dhe të rrisë kompetencat profesionale të studentëve nëpërmjet njohjes së aktivitetit fizik dhe shëndetit në popullatë. Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale të një viti akademik, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e "Ciklit të Dytë" në "Aktivitet Fizik dhe Shëndet".

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Master i Shkencave në "Aktivitet Fizik dhe Shëndeti", është hartuar nga dy ekspertë me përvojë akademike dhe eksperiencën në fushën e mjekësisë dhe të aktivitetit fizik, **Prof.Dr. Bledar Kraja** dhe **Prof. Asoc. Roland Çerepi**, me mbështetjen e Koordinatorit Teknik të ASCAL **Msc. Arbri Ndreka.**

Procesi i vlerësimit të jashtëm është realizuar sipas programit të miratuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe Universiteti i Sporteve të Tiranës, bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017" dhe kishte për qëllim vlerësimin e nivelit të përmbushjes së Sstandarteve Shtetërore të Cilësisë për Arsimin e Lartë sipas përcaktimeve ligjore në fuqi në momentin e vlerësimit.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka shqyrtuar kuadrin ligjor në fuqi për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë ligjin dhe aktet nënligjore përkatëse, si më poshtë:

- Ligji Nr. 80/2015, Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.
- VENDIM Nr. 57, datë 29.1.2020 Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë.
- Vendim i KM nr.185, datë 25.3.2021. Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshua
- Vendim i KM nr. 824, datë 24.12.2021, "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 629, datë 10.10.2024 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre"
- VKM nr. 165, datë 21.03.2018 "Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë".
- Manual për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) analizoi të gjitha dokumentet e përfshira në Raportin e Vleresimit të Brendshme, në Dosjen e Vetëvlerësimit në sistemin AMS, si dhe informacionin e mbledhur gjatë vizitës në institucion, për të hartuar këtë raport vlerësimi.

GVJ realizoi vizitën në Universiteti e Sporteve më datë 29 Korrik 2025, ku u zhvilluan takime me përfaqësues të institucioni për të kuptuar më në thellësi dhe për të verifikuar aspektet e vlerësimit të brendshëm të paraqitur.

Procesi i vlerësimit filloi me një takim me Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit, ku u diskutuan: bashkëpunimet akademike, prezantimet në konferenca, publikimet shkencore, sigurimi i fondeve të jashtme, programi për ndjekjen e ALUMNI-ve, nismat për përmirësime dhe zhvillimi profesional i stafit.

Më pas, ekipi i vlerësimit të jashtëm zhvilloi takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit, ku u diskutuan: përgatitja e raportit të vetëvlerësimit, botimet e revistës së universitetit, kompetencat e fituara nga studentët, përvojat praktike dhe përmirësimet e realizuara.

Në vijim, GVJ zhvilloi një takim me studentë e programit, ku u diskutuan temat: krahasimi i cilësisë së mësimdhënies me universitete të tjera të mëparshme, kërkimi shkencor dhe publikimet, mbështetja për orientimin në karrierë, puna praktike dhe tezat, stazhet dhe mbikëqyrja akademike.

Takimi i radhës u zhvillua me stafin akademik të angazhuar në këtë program, ku u trajtuan çështjet: ndërdisiplinariteti i programit, strategjitë për zgjerimin e qasjes akademike, mënyrat për të siguruar përvetësimin e thelluar të njohurive dhe propozimet për përmirësim të mëtejshëm të programit.

Takime të mëtejshme u zhvilluan me përfaqësues nga Burimet Njerëzore, Njësia e Sigurimit të Cilësisë, si dhe nga zyrat e Marrëdhënieve me Jashtë, Projekteve dhe Kurrikulave. Gjatë këtyre takimeve u diskutuan: procesi i punësimit të stafit, trajtimi i ankesave, verifikimi i rastësishëm i një CV-je të një pedagogu me zyrën burimeve njerëzore, analizimi i pyetësorëve për studentët dhe rezultatet përkatëse, si dhe projektet në zhvillim si EU4Sports, ruajtja e të dhënave dhe përmirësimet e planifikuara.

Si hap përfundimtar i vlerësimit, GVJ realizoi një vizitë të ambienteve të përdorura nga programi, laboratorë, biblioteka, klasa dhe terrene sportive,

Anëtarët e GVJ-së kanë bashkëbiseduar dhe janë dakordësuar mbi gjetjet dhe përfundimet e paraqitura në këtë raport, në funksion të vlerësimit të përmbushjes së standardeve për cilësinë e programit të studimit. Për të ofruar një vlerësim sa më objektiv, procesi ka përfshirë si analizën sasiore të të dhënave, ashtu edhe gjykimin profesional mbi rëndësinë e secilit kriter në përmbushjen e standardeve të cilësisë.

**SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT**

**I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 19, datë 19.02.2021 janë:**

1. Institucioni, të rrisë mbështetjen e stafit akademik dhe studentëve për realizimin e aktivitetet kërkimore shkencore.
2. Institucioni, të rrisë kapacitetet e tij laboratorike dhe mjediset sportive, në funksion të këtij programi studimi.
3. Institucioni, të hartojë një plan zhvillimi të vazhdueshëm për rritjen profesionale të stafit akademik të këtij programi studimi.
4. Institucioni, të institucionalizojë marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet punëdhënëse, në kuadër të realizmit të trajnimeve dhe praktikave profesionale të studentëve.
5. Institucioni, të përfshijë në kurrikulën e programit të studimit, lëndë/module në gjuhën angleze, me qëllim rritjen e mobilitetit të studentëve dhe ndërkombëtarizimin e programit të studimit.
6. Institucioni, të bëjë publike në faqen e tij të internetit, informacione mbi programin e studimit si: përbërjen e stafit akademik, planin mësimor, rregulloren e programit të studimit etj.
7. Institucioni, të hartojë një raport mbi efektivitetin dhe përfitimet e marrëveshjeve të bashkëpunimit që kanë në fokus internshipet dhe praktikat e studentëve të këtij programi studimi.
8. Institucioni, të marrë masa për rritjen e përdorimit të teknologjisë inovative, në kuader të nevojave të këtij programi studimi.

**II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni**

**1. Mbështetja e stafit akademik dhe studentëve për aktivitete kërkimore-shkencore**:

GVJ duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe në vizitën në Institucion konsataton se ky kriter **plotësohet kryesisht.** Pavarësisht se UST ka ritur mbështetjen për kërkimin shkencor nëpërmjet financimeve të dedikuara për projekte të ndryshme si dhe bashkëpunime me institucione kombëtare e ndërkombëtare përsëri vihet re mungesë e organizimit të konferencave shkencore kombëtare periodike.

**2.Rritja e kapaciteteve laboratorike dhe mjediseve sportive:**

GVJ duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe në vizitën në Institucion konsataton, se ky kriter **plotësohet kryesisht**. Pavarësisht se Institucioni ka investuar në përmirësimin e infrastrukturës laboratorike duke përfshire pajisjen e laboratorit

të biomekanikës, të fiziologjisë së ushtrimit dhe të rehabilitimit me aparatura moderne, infrastruktura sportive nuk është e plotë dhe akoma vazhdon rikonstruktimi i disa ambienteve sportive në funksion të zhvillimit të praktikave mësimore dhe kërkimore.

**3.Plan zhvillimi për rritjen profesionale të stafit akademik**:

GVJ duke u bazuar në dokumantacionin e dorëzuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe në vizitën në Institucion konsataton se ky kriter **plotësohet kryesisht**. Aftësitë e përmirësuara të lektorëve bazohen më shumë në përpjekje individuale, sesa në një politikë të strukturuar institucionale për zhvillim profesional.

4. **Institucionalizimi i marrëveshjeve me institucionet punëdhënëse:**

GVJ duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe në vizitën në Institucion konsataton se ky kriter **plotësohet plotësisht**. UST ka formalizuar bashkëpunimet me institucione si Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, federatat sportive dhe qendrat rehabilituese, per realizimin e praktikave të studentëve.

**5. Përfshirja e lëndëve/moduleve në gjuhën angleze**:

GVJ duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe në vizitën në Institucion konsataton se **ky kriter nuk përmbushet**.

**6. Publikimi i informacionit në faqen zyrtare:**

GVJ duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe në vizitën në Institucion konsataton se ky kriter **plotësohet plotësisht**. Faqja zyrtare e UST është përditësuar me informacione të detajuara për cdo program studimi, përfshirë përbërjen e stafit, planin mësimor, rregulloren dhe kriteret e pranimit. Gjithashtu, janë shtuar rubrika interaktive për sistemin PITAGORA të studentëve, Office 365 etj.

**7. Raport mbi efektivitetin e marrëveshjeve të bashkëpunimit:**

GVJ duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe në vizitën në Institucion konsataton se ky kriter **plotësohet kryesisht**. Pavarësisht se departamentet përkatëse, në bashkëpunim me Zyrën ALUMNI, dhe NJSBC kanë përgatitur raporte periodike që analizojnë efektivitetin e bashkëpunimeve për praktikat studentore, mungojnë raportet e përfitimeve nga marrëveshjet ndërkombëtare.

**8. Rritja e përdorimit të teknologjisë innovative:**

GVJ duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe në vizitën në Institucion konstaton se ky kriter **plotësohet plotësisht**. Janë integruar teknologji të reja në procesin mësimor, si përmirësim për platformat digjitale, softuerë për analizën e lëvizjes dhe aplikacione për monitorimin e performancës fizike të studentëve / subjekteve të kërkimeve shkencore (BOD POD për analizën e përbërjes trupore etj).

IAL është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 03.11.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr.168/13 Prot, datë 03.11.2025. IAL njofton në ASCAL më datë 10.11.2025, me anë të shkresës me Nr.2677/2 Prot, datë 07.11.2025 "Kthim përgjigje për Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", ku shprehin dakortësinë. Në këtë mënyrë Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencavenë "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti"**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Programi i studimit Master i Shkencave në "Aktivitet Fizik dhe Shëndet" nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe është konceptuar në përputhje me dispozitat kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.<br>GVJ konstaton se programi synon të përgatisë profesionistë të kualifikuar, të cilët do të kenë vlerë të shtuar për tregun e punës dhe do të kontribuojnë në përmirësimin cilësor të arsimit të lartë në vend.<br><br>*Ref.2. Statuti i Universitetit të Sporteve. Misioni Neni 5*<br>*Ref.2 Statuti i Universitetit të Sporteve, Vizioni. Neni 4.* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programi përgatit studentët për të ndjekur një karrierë në fushën e aktivitetit fizik dhe shëndetit, duke u ofruar atyre njohuri të thelluara dhe gjithëpërfshirëse në këtë fushë komplekse dhe me rëndësi profesionale. Ai është ndërtuar mbi parime që mbështesin interesin publik dhe kombëtar, si dhe është në përputhje me misionin institucional të ofruesit të programit.<br><br>*Ref.2. Statuti i Universitetit të Sporteve, Misioni, Neni 5:*<br>*Ref.3. Plani Stratcgjik FVFR 2021-2026, Misioni.*<br>*Ref.4. Plani Strategiik UST 2021 -2026, Objektivat* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit. | Megjithëse kontributi i drejtpërdrejtë në zhvillimin lokal dhe ekonomik është i kufizuar për shkak të numrit të vogël të studentëve dhe përmasave të vogla të sektorit të sportit në Shqipëri, gjatë vlerësimit u raportua nga stafi akademik se përmes strukturës së lëndëve, organizimit të praktikave dhe programeve të aktivitetit fizik, programi synon të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e shëndetit të popullatës, duke kontribuar në parandalimin e obezitetit dhe sëmundjeve të lidhura me moshën. Ai është hartuar në përputhje me misionin e Institucionit që orientohet drejt krijimit, zhvillimit, e transmetimit të dijeve në aftësi dhe kompetenca të studentëve, të nevojshme këto, për t'u |

| | |
|---|---|
| | bërë ekspertë të denjë të fushës së aktivitetit fizik dhe shëndetit.<br><br>*Ref.2. Statuti i Universiteti të Sporteve. Misioni. Neni 5*<br>*Ref. 14. Plan i mësimor MSH në "Aktivitet Fizik dhe Shendet"* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | Programi përputhet me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe është në gjendje të zhvillojë kompetenca të nevojshme për ndjekjen e ciklit të tretë të studimeve, duke përfshirë trajnimin e thelluar profesional dhe aftësitë kërkimore shkencore.<br>Megjithatë, lidhur me tendencat globale të zhvillimit, programi aktual nuk reflekton në masë të mjaftueshme nevojat bashkëkohore dhe ndërkombëtare të fushës. Një nga fushat në zhvillim të shpejtë është përpunimi i të dhënave dhe analiza statistikore në kontekstin e aktivitetit fizik dhe shëndetit, ndërveprimi i elementeve të ushqyerjes me aktivitetin fizik dhe shendetin si dhe përfshirja e moduleve ndërdisiplinore më fokus në shëndetin publik. *Aktualisht, programi i studimit nuk ka pësuar asnjë ndryshim që nga momenti i licensimit duke sjellë një mungesë të përafrimit me trendet globale si dhe të përditësimit të literaturës së përdorur.*<br><br>*Ref.3. Plani Strategiik FVFR 2021-2026, Misioni. pika 2;*<br>*Ref.4. Plani Strategijik UST 2021-2026. Objektivat*<br>*Ref. 5. VKM Nr.41, datë 24.01.2018, Per elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL.*<br>*Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MSH në Aktivitet Fizik dheShëndet, neni 4, (Veprimtaritë formuese të programit të studimit).* |
| **Konkluzione** | *Programi Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti" është në përputhje me ligjet dhe interesat kombëtare të Shqipërisë dhe synon të përgatisë profesionistë të kualifikuar në këtë fushë. Ai kontribuon në përmirësimin e arsimit të lartë dhe shëndetit publik, ndonëse ndikimi i tij ekonomik është i kufizuar për shkak të përmasave të vogla të sektorit të sportit. Programi është i ndërtuar mbi parime që mbështesin zhvillimin kombëtar dhe përgatit studentët për studime të mëtejshme.*<br>*Megjithatë, ai nuk pasqyron mjaftueshëm tendencat globale dhe mungon përditësimi i përmbajtjes dhe literaturës që nga momenti i licencimit të tij.*<br>*GVJ rekomandim se IAL duhet të:*<br>• *Rishikojë dhe përditësojë planin mësimor për të përfshirë module bashkëkohore mbi ushqyerjen dhe shëndetin publik.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | • *Përafronte literaturën e përdorur me kërkimet dhe burimet më të fundit ndërkombëtare.*<br>• *Sigurojë integrimin e përmbajtjeve ndërdisiplinore për të rritur përshtatshmërinë e programit me zhvillimet globale dhe nevojat e tregut.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi I.2**<br>**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Programi i studimit MSc në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti" ofrohet nga Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit në Fakultetin e Veprimarive Fizike dhe Rekreacionit (FVFR) i cili për vitin e fundit akademik ka 9 PAE, ndërsa në total fakulteti ka 26 PAE. Struktura organizative e këtij fakulteti është në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, dhe përbëhet nga tre departamente të mbështetura nga staf akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, me angazhim të plotë dhe të pjesshëm.<br>Megjithatë, duke pasur parasysh që të gjitha departamentet ofrojnë programe studimi aktive, dhe në bazë të vlerësimit në terren dhe të intervistave, GVJ konkludon se institucioni megjithëse i zotëron kapacitetet e nevojshme akademike për të mbështetur programin MSc në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", nuk i shfrytëzon plotësisht ato. Gjithashtu, *IAL nuk i zotëron të gjitha kapacitet infrastrukturore sipas VKM nr. 629, datë 10.10.2024 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre" që të mbështësë këtë program studimi.*<br><br>*Ref.21. Formati i Dosjes Personale te Stafit Akademik*<br>*Ref.2 1.1. CV e stafit akademik te programit te studimit*<br>*Ref.21.2. CV e stafit ndihmes akademik*<br>*Ref.23. Te dhena tabelore per personelin akademik ne Njesine Kryesore dhe njesine pergjegjese*<br>*Ref. 23.1. Te dhena tabelore per personelin akademik ne* |

| | |
|---|---|
| | *programin e studimit* |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Fusha e këtij programi është në përputhje të plotë me profilin akademik dhe kërkimor të Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit. Ekziston një koherencë e qartë ndërmjet objektivave të programit MSc dhe fushës së veprimtarisë akademike dhe shkencore të njësisë përkatëse. Programi gjithashtu përputhet me drejtimet akademike dhe kërkimore të Departamentit të Lëvizjes dhe Shëndetit, duke përforcuar legjitimitetin e tij shkencor dhe institucional.<br><br>*Ref.2.2 Statuti i Universitetit te Sporteve. Neni I0.*<br>*Ref.3 Plan i Strategjik FVFR 2021-2026, Misioni, pika 2*<br>*Ref.4 Plani Strategjik UST 2021 -2026. Objektivat*<br>*Ref.7. Rregullore e Universitetit te Sporteve. Nen i 47. neni 48.*<br>*Ref.8.I Rregullore e FVFR-s, neni 5.* |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit është në harmoni me profilin akademik dhe kërkimor të njësisë përgjegjëse. Ky program përfshin një gamë të gjerë lëndësh dhe leksionesh, të cilat i mundësojnë studentëve të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që përputhen me kërkesat e tregut të punës dhe rrisin mundësitë për punësim.<br><br>*Ref.2.2. Statuti i Universitetit te Sporteve. Neni I0 (Njesite perberese te Universitetit te Sporteve):*<br>*Ref.7.I Rregullore e Universitetit te Sporteve. Neni 4*<br>*Ref.2.I Statuti i Universitetit te Sporteve. Neni 4*<br>*Ref.4.1 Plan i Strategiik UST 2021 -2026. Objektivat, KerkimiShkencor.*<br>*Ref.8.I Rregullore e FVER, neni 5.*<br>*Ref. 9 Rregullore e Departamentit Lëvizja dhe Shëndeti.* |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | **N/A** |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në | Pavarësisht se studentët kanë mundësi të ndjekin studime të doktoraturës apo u ofrohet këshillim falas për karrierën, nga intervistat dhe referencat e paraqitura *nuk konstatohet që IAL ofron kurse trajnimi profesionale të mëtejshme për studentët në* |

| | |
|---|---|
| bashkërendim me punëdhënësit. | *bashkëpunim më punëdhënësit.* Ato mund të ofronin kurse profesionale specifike mbi ndërveprimin e ushqyerjes me aktivitetin fizik dhe shëndetin, apo ndikimin e aktivitetit fizik në grupe të caktuara të popullatës si p.sh tek fëmijët adoleshentët apo ato me aftësi të kufizuara.<br><br>*Ref.36 Relacion i aktivitetit te zyres se keshillimit te karrieres*<br>*Ref.33 Te dhena tabelore per cilesine ne hyrje dhe dalje te studenteve* |
| **Konkluzione** | *Programi MSc në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti" ofrohet nga Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit në Fakultetin e Veprimtarive Fizike dhe Rekreacionit, i cili ka një strukturë organizative në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 dhe kapacitete akademike të mjaftueshme për zhvillimin e tij. Programi është plotësisht i harmonizuar me profilin akademik dhe kërkimor të fakultetit dhe departamentit, duke ofruar lëndë dhe kompetenca të përshtatura me kërkesat e tregut të punës.*<br>*Megjithatë, kapacitetet ekzistuese akademike dhe infrastrukturore nuk shfrytëzohen plotësisht. Një pjesë e stafit ka mbingarkesë orësh mësimore mbi kufijtë e përcaktuar nga udhëzimi përkatës, dhe mungojnë disa standarde infrastrukturore sipas VKM nr. 629/2024. Gjithashtu, nuk ofrohen kurse trajnimi profesionale të mëtejshme në bashkëpunim me punëdhënësit, të cilat do të mund të shtonin vlerën praktike të programit.*<br>*GVJ rekomandon se IAL duhet të:*<br>• *Plotësojë mungesat infrastrukturore sipas standardeve kombëtare.*<br>• *Zhvillojë dhe ofrojë kurse trajnimi profesionale të specializuara në bashkëpunim me punëdhënësit, sidomos në fusha si ushqyerja dhe aktiviteti fizik, apo ndikimi i tij tek grupet e veçanta të popullsisë.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi I.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Institucioni ka vendosur mekanizma të bashkëpunimit të brendshëm për hartimin, mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e programit të studimit MSc. Janë krijuar marrëdhënie efektive bashkëpunimi ndërmjet njësive të brendshme, duke garantuar koherencë dhe përputhje me objektivat akademikë të programit. Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit, si njësi përgjegjëse për programin, mbikëqyr aktivitetet e tij akademike dhe organizative.<br><br>*Ref.2.3. Statuti i Universitetit te Sporteve, Kreu I,II,I,IV;*<br>*Ref.7.2. Rregullore e Universitetit te Sporteve. Neni 3 -21: 2 3 -27;*<br>*Ref.2.4. Statuti i Universitetit te Sporteve. Neni 13,Nen i 38.39;* |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST) bashkëpunon me institucione publike dhe private, brenda dhe jashtë vendit, për të qëndruar i përditësuar me kërkesat e tregut të punës dhe për t'i reflektuar ato në përmbajtjen e programit të studimit.<br>Fakulteti ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione akademike të huaja dhe shqiptare si dhe me Institucione qeveritare dhe jo qeveritare për praktikat e studentëve. *Rekomandohet një shfrytëzim më i plotë i këtyre marrëveshjeve, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së stafit akademik në aktivitete trajnuese dhe kërkimore, si dhe për krijimin e mundësive më të mëdha për stazhe studentore.*<br><br>*Ref.4. Plani strategjik UST 2021-2026. Objektivat*<br>*Ref. 24.Lista e Marreveshjeve Nderkombetare dhe Kombetare*<br>*Ref.24.1. Mareeshije Bash#epumnimi me Federaten Shqiptare te Futbollit.*<br>*Ref.25. Raporti i perfitimeve nga marreveshjet e bashkepunimit* |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për | Vlerësohet se bashkëpunimet ekzistuese me punëdhënës dhe institucione të mundshme për praktika profesionale dhe trajnime janë ende në një fazë informale. *Rekomandohet që këto bashkëpunime të formalizohen përmes marrëveshjeve zyrtare dhe të ndërtohet një sistem mentorimi për mbështetjen e studentëve gjatë stazheve.*<br>Institucioni ka eksperiencë në fushën e mobilitetit të stafit dhe studentëve, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, dhe angazhohet për të garantuar cilësinë dhe ndikimin e këtyre aktiviteteve tek përfituesit. UST ka nënshkruar marrëveshje për pjesëmarrje në programin Erasmus+ dhe po punon për krijimin e një mjedisi mbështetës për mobilitetin ndërkombëtar. Institucioni është i hapur |

| | |
|---|---|
| kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve. | ndaj studentëve dhe stafit të huaj. *Megjithatë, vihet re mungesa e lëndëve në gjuhë të huaj, që do të përforconte kapacitetet për integrimin e pjesëmarrësve ndërkombëtarë.*<br><br>*Ref. 24. Lista e Marreveshjeve Nderkombetare dhe Kombetare.*<br>*Ref.25. Raporti i perfitimeve nga marreveshjet e bashkepunimit.*<br>*Ref.18. Model Analize vjetore e DLSH.*<br>*Ref. I8.I. Model Anal ize vjetore te FVFR*<br>*Ref.37 Percjellje raporti vjetor per vitin 2023- 2024, ne nivelRektorati.* |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | UST ka realizuar bashkëpunime të ndryshme dhe ka hartuar një raport mbi përfitimet e marrëveshjeve të bashkëpunimit. Pas shqyrtimit të këtij raporti, GVJ vlerëson se ai duhet të jetë më i qartë dhe më i strukturuar, duke theksuar në mënyrë konkrete përfitimet e sjella për institucionin nga këto marrëveshje.<br><br>*Ref. 18. Model Analize vjetore e DLSH.* |
| **Konkluzione** | *Institucioni ka vendosur mekanizma bashkëpunimi të brendshëm për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit MSc në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", duke siguruar koherencë me objektivat akademikë. UST bashkëpunon me institucione vendase e të huaja për të përshtatur programin me kërkesat e tregut të punës dhe ka marrëveshje për praktika studentore. Megjithatë, këto marrëveshje nuk shfrytëzohen plotësisht dhe bashkëpunimet me punëdhënës janë ende kryesisht informale. Institucioni ka përvojë në mobilitetin e stafit dhe studentëve, përfshirë pjesëmarrjen në Erasmus+, por mungesa e lëndëve në gjuhë të huaj kufizon integrimin ndërkombëtar. Raporti mbi përfitimet e marrëveshjeve ekzistuese është hartuar, por i mungon struktura dhe qartësia për të treguar rezultatet konkrete.*<br>*GVJ rekomandon se IAL duhet të:*<br>• *Shfrytëzojë plotësisht marrëveshjet ekzistuese për të rritur pjesëmarrjen e stafit në trajnime dhe kërkime si dhe mundësitë për stazhe studentore.*<br>• *Formalizojë bashkëpunimet me punëdhënës përmes marrëveshjeve zyrtare dhe të krijojë një sistem mentorimi për studentët gjatë praktikave.*<br>• *Ofrojë lëndë në gjuhë të huaj për të përforcuar integrimin e studentëve dhe stafit ndërkombëtar.*<br>• *Përmirësojë raportin mbi marrëveshjet e bashkëpunimit duke* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *e bërë më të qartë, të strukturuar dhe me fokus në përfitimet konkrete për institucionin.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit Master Shkencor (MSc) i ofruar nga Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST) është hartuar dhe zbatohet në përputhje Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe me aktet nënligjore përkatëse, përfshirë VKM nr. 41/2018, të ndryshuar. Gjithashtu, zbatohen udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Programi është i strukturuar në module të vlerësuara sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS), me një total prej 120 ECTS të shpërndara në një periudhë dyvjeçare. Çdo vit akademik përmban 60 ECTS, të ndara në afërsisht 30 ECTS për semestër, me një kohëzgjatje standarde prej 15 javësh për semestër. Neni 17 i rregullores se Departamentit përcakton minimalisht 30 kredite për semestër por programi nuk i ka të ndara në mënyë të barabartë.<br>Disiplinat e programit janë të organizuara në pesë kategori, si më poshtë:<br>Kategoria A: 12 ECTS (10%) –lëndë bazë; (kërkesa: 5–10%)<br>Kategoria B: 64 ECTS (53.3%)–lëndë karakterizuese; (kërkesa: 50–60%)<br>Kategoria C: 20 ECTS (16.6%) –lëndë me zgjedhje; (kërkesa: |

| | |
|---|---|
| | 12–20%)<br>Kategoria D: 12 ECTS (10%) – praktikë profesionale; (kërkesa: 10%)<br>Kategoria E: 12 ECTS (10%) –temë diplome; (kërkesa: 10–15%)<br>Shuma e kategorive A dhe B është 76 ECTS, që përfaqëson 63.3% të totalit të programit, në përputhje me kërkesën që ky raport të mos jetë më pak se 60%, sipas VKM nr. 41/2018, te ndryshuar.<br><br>*Ref.14. Plan i mësimor nE MSH Aktivitet Fizik dhe Shëndet*<br>*Ref.8.2. Rregulloree FVFR-s. neni 40.* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Programi MSc është ndërtuar për të ofruar një kombinim të njohurive teorike dhe aftësive praktike në fushën e aktivitetit fizik, sportit dhe shëndetit.<br>Objektivat kryesore të programit përfshijnë:<br>• Pajisjen e studentëve me njohuri bazë dhe të specializuara në disiplinat përkatëse.<br>• Zhvillimin e aftësive praktike dhe profesionale të aplikueshme në tregun e punës.<br>• Krijimin e mundësive për studime të thelluara dhe specializime të mëtejshme.<br>Në programin e studimit janë përfshirë module karakterizuese dhe të përgjithshme të fushës së sportit dhe edukimit shëndetësor të cilat iu krijojnë studentëve koncepte dhe aftësi të lidhura me specialitetin e tyre.<br><br>*Ref.6. Rregullore e programit te Studimit MSH ne Aktivitet Fizik dhe Shendet.*<br>*Ref.14. Plan i mesimor MSH ne Aktivitet Fizik dhe Shendet"* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Programi përmban elementë të qartë të përgatitjes për tregun e punës dhe integron praktikën profesionale si pjesë të domosdoshme të formimit të studentëve. Programi është i strukturuar në grup-lëndë sipas kategorive të formimit duke respektuar kërkesat e kuadrit ligjor. Programi përmban 12 lëndë (108 kredite ECTS në total), duke përfshire provimin përfundimtar / (12 ECTS) si dhe ka 40 orë praktike/1200 orë në total.<br>Nga intervistat e bëra u kanstatua se në përputhje me rregulloret e programit shpenzimet për praktikat mbulohen nga IAL<br><br>*Ref.6. Rregullore e programit te Studimit MSH ne Aktivitet Fizik* |

| | |
|---|---|
| | *dhe Shendet.*<br>*Ref. 14. Plani mesimor MSH ne Aktivitet Fizik dhe Shendet*<br>*Ref. 9. Rregullore e Departamentit te DLSH.* |
| **Kriteri 4.**Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit. | **N/A** |
| **Kriteri 5.**Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. | **N/A** |
| **Kriteri 6.**Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Programi i studimit përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e një programi studimi sipas ligjit 80/2015, VKM nr.41. datë 24.01.2018 të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore duke qenë se UST i përket IAL me status të veçantë.<br><br>*Ref.6. Rregullore e programit te Studimit MSH ne Aktivitet Fizik dhe Shendet.*<br>*Ref.4. Plan i mesimor MSH ne "Aktivitet Fizik dhe Shendet"*<br>*Ref. 9 Rregullore e Departamentit te DLSH.*<br>*Ref.38 Dhenia e statusit te vecante per Universitetin e Sporteve te Tiranes. VKM Nr.57, date 29.01 .2020* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Bazuar në Udhëzimin e MAS Nr. 31. 15.01.2022, për "Proçedurat për Kodifikimin e Programeve të Studimit të Ofruara nga Instituticionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Universiteti i Sporteve ka vendosur kodifikimin e programeve që ofon në fushën e vet. Duke marrë në konsideratë se në nivel kombëtar numri i programeve master në këtë drejtim është i ulët si dhe programet e së njëjtës fushë që ofron UST (Kodi 0988 Programe dhe kualifikime ndërdisiplinore që përfshijnë shëndetin dhe mirëqenien), programi i studimit MSc Aktivitet Fizik dhe Shëndet, është unik.<br><br>*Ref. 39 Procedurat për Kodifikimin e Programeve të Studimit të Ofruara nga Instituticionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërise, Universiteti i Sporteve te Tiranes, Master Shkencor. FVER.* |
| **Kriteri 8.**Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Kodi i programit i vendosur në Universitetin e Sporteve është 72MS0988S. Kodifikimi është bërë bazuar në Vendim nr. 310, datë 11.5.2022 Kodifikimi i programeve të studimit të ofruara nga IAL dhe Udhëzimin Nr. 31, të MAS duke reflektuar në të elementët enevojshëm. Programi është pjesë e ciklit të dytë të studimeve,referuar nivelit të 7 ëE Kornizës Shqiptare të Kualifikimeveorganizohet me 120 ECTS dhe kohëzgjatje normale 2 (dy) viteakademik me kohëtë plotë.<br>Brenda afateve ligjore të përcaktuara në Udhëzim (pika 12), UST ka dërguar në Ministrinë e Arsimit propozimet për Kodifikimet e Programve që ofron. Megjithatë, nuk ka dokumentacion që kodifikimi i programit, bazuar në aktet ligjore të mësipërme, të jetë miratuar nga Ministra e Arsimit e cili ka sjelle si pasojë edhe moskodifikimin e lendëve të programit.<br><br>*Ref. 39 Procedurat për Kodifikimin e Programeve të Studimit të Ofruara nga Instituticionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërise, Universiteti i Sporteve te Tiranes, Master Shkencor. FVER.* |
| **Kriteri 9.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në | **N/A** |

| | |
|---|---|
| fuqi. | |
| **Konkluzione** | *Bazuar në intervistat e zhvilluara dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur, vlerësohet se:*<br>*•Programi përputhet plotësisht me kërkesat e legjislacionit në fuqi.*<br>*•Strukturimi i moduleve dhe përqindjet sipas kategorive janë në përputhje me udhëzimet ligjore dhe standardet e cilësisë.*<br>*•Objektivat dhe përmbajtja e programit janë të përcaktuara qartë dhe adresojnë nevojat e tregut të punës.*<br>*Programi i studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti FIzik dhe Shëndeti", përmbush kriteret ligjore dhe akademike për ofrimin e një cikli të dytë studimesh në përputhje me standardet kombëtare. Përmbajtja, struktura dhe rezultatet e të nxënit janë të orientuara drejt formimit të plotë akademik dhe profesional të studentëve. Megjithatë, mungojnë kodet e programit të studimit si dhe kodet lendëve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Programit të Studimit të Ciklit te Dytë, Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015, date 05.10.2015, "Per arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërise", në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST), në Rregulloren e Përgjithshme të UST-sE, në Rregulloren e Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, në Rregulloren e Departamentit Lëvizja dhe Shëndeti.<br>Universitetit të Sporteve të Tiranës ka akreditim Institucional deri në Janar 2028 me Vendim teë BA nr.02 datë 07.01.2022.<br>Departamenti përgjegjës: Departamenti Lëvizja dhe Shëndeti<br>Fakulteti përgjegjës: Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit.<br>Struktura të tjera bashkëpunuese Brenda IAL: Fakulteti i Shkencave te Lëvizjes, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit dhe ISKSH |

| | |
|---|---|
| | Personeli akademik i programit të studimit në vitin akademik 2024-2025 përbëhet nga 26 personel akademik efektiv dhe asnjë personel akademik me kontratë, nga ku 14 janë me grada dhe tituj dhe 12 janë në proces Doktorature.<br>Stafi akademik i Departamentit të Lëvizjes dhe Shëndetit për vitin akademik 2024-2025 është i përbërë nga 9 pedagogë, ku 6 janë me tituj dhe grada, e 3 janë në proces Doktorature.<br>Strukturat akademike përgjegjëse përmbushin të gjitha detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi në lidhje me numrin e personelit akademik, kualifikimet, numrin e lëndëve të zhvilluara dhe përputhshmërinë e lendës me përgjegjësin e saj.<br><br>*Ref. 9 Rregullore e Departamentit të Lëvizjes dhe Shendetit.*<br>*Ref. 23. Te dhëna tabelore për personelin akademik ne Njësinë Kryesore dhe njësinë përgjegjëse;*<br>*Ref.23.1. Te dhëna tabelore për personelin akademik në programine studimit.*<br>*Ref.23.3. Te dhëna tabclore për numrin e programeve që ofirohen nga njësia përgjegjëse.* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Një kontribut të rëndësishëm në realizimin e programit të studimit jep personeli ndihmës akademik i cili angazhohet në realizimin dhe mbarëvajtjen e orëve mësimore si dhe të orëve laboratorike dhe praktike.<br><br>*Ref. 9 Rregullore e Departamentit të Lëvizjes dhe Sh&ndetit.*<br>*Ref. 23. Te dhëna tabelore për personelin akademik ne Njësinë Kryesore dhe njësinë përgjegjëse;*<br>*Ref.23.1. Te dhëna tabelore për personelin akademik në programinestudimit.*<br>*Ref.23.3. Te dhënatabclore për numrin e programeve që ofirohen nganjësia përgjegjëse.* |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e | Drejtuesi i Departamentit është autoriteti më i lartë akademik për departamentin. Detyrat dhe kompetencat e tij janë të drejtojë punën për hartimin e planeve mësimore dhe programeve të lëndëve që mbulon departamenti dhe ndjek zbatimin e tyre, ndjek dhe kontrollon aktitivitetin shkencor në department, në përputhje me planifikimin vjetor, mban dokumentacionin e aktiviteti shkencor dhe akademik të anëtarëve të departamentit. Fakulteti nëpërmjet Drejtuesit të Departamentit cakton cdo vit një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave |

| | |
|---|---|
| tij. | profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht drejtuesin e departamentit qoftë nëpërmjet takimeve verbale apo në takime të tjera që realizohen gjatë vitit akademik.<br><br>*Ref.6. Rregullore e programit te Studimit MSH në Aktivitet Fizik dhe Shëndet*<br>*Ref.8.3 Rregullore e FVFR-s, neni 13.Koordinatori i Programit të Studimit* |
| **Konkluzione** | *Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe Departamenti Lëvizja dhe Shëndeti, përgjegjes për programin e studimit, janë të organizuara bazuar në kërkesat e legjislacionit ne fuqi përorganizimin dhe strukturën akademike.*<br>*GVJ konisderon pikë të forte punësimin dhe përfshirjen e personelit akademik me kualifikime multidisiplinare si nga fusha e mjekësisë, shkencave të natyrës, etj.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit janë të dokumentuara dhe menaxhohen nga njësia bazë përgjegjëse, në përputhje me të dhënat e mbledhura gjatë vizitës në terren. Dokumentacioni përmban informacion të plotë mbi përmbajtjen e programit, ndërsa bazuar në intervistat e zhvilluara, ky kriter konsiderohet i përmbushur.<br><br>*Ref. 20. Dosja e Program/Syllabus:*<br>*Ref.21. FormatiDosjes Personale te Staf kademik;*<br>*Ref.21.1. CV e stafit akademik te programit te studimit;*<br>*Ref.21.2. CV e stafitndihmes akademik* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në | Programi i studimit është i strukturuar në module, duke përfshirë edhe komponentin e praktikës profesionale, e cila realizohet në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.<br>Lëndët janë të organizuara në 13 module, të cilat në total përbëjnë 120 ECTS, të shpërndara në mënyrë të balancuar gjatë ciklit të |

| | |
|---|---|
| semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | studimeve.<br>Programi ofron një përshkrim të detajuar mbi shpërndarjen e lëndëve dhe moduleve sipas semestrave, si dhe mbi ngarkesën mësimore, duke garantuar transparencë për strukturën e tij akademike.<br>Struktura e ngarkesës mësimore për programin Master është si më poshtë:<br>• 42% leksione<br>• 13% seminare<br>• 42% orë laboratorike<br>• 3% praktikë profesionale<br><br>*Ref.14. Plani mësimorMSH ne "AktivitetFizikdhe Shëndet";*<br>*Ref. 5. VKM Nr.41, date 24.01.2018, "Per elementet e programeve te Studimit te ofruara nga ILA, te ndryshuar.* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Rregullorja e programit e hartuar në përputhje me aktet normative të Universitetit dhe të Fakultetit përkatës përfshin edhe dispozita të qarta mbi procedurat e transferimit të studentëve nga ose drejt institucioneve të tjera të arsimit të lartë. Gjithashtu, përshkruhen qartë kriteret e përgjithshme dhe specifike për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve, të cilat janë të pasqyruara në rregullore.<br><br>*Ref.14. Plani mësimorMSH ne "AktivitetFizikdhe Shëndet";*<br>*Ref. 5. VKM Nr.41, date 24.01.2018, "Per elementet e programeve te Studimi tte ofruara nga ILA, te ndryshuar.* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Të gjitha lëndët e programit janë të strukturuara dhe të pasuruara me komponentët e nevojshëm për të informuar studentët mbi përmbajtjen e kursit, temat që trajtohen, detyrimet akademike dhe mënyrën e vlerësimit. Gjithashtu, ato përfshijnë udhëzime të qarta mbi politikat dhe pritshmëritë për secilin kurs. Ato janë hartuar në përputhje më VKM Nr. 41, datë 24.1.2018, e ndryshuar duke pasqyruar të giith elementët që parashikohen në shtojcën e këtij vendimi.<br>Megjithatë, forma dhe përmbajtja e programeve lëndore mund të ndryshojnë në varësi të disiplinës, kursit dhe pedagogut. Gjithashtu, *GVB konstaton se literatuara e përdorur bazë dhe ndihmëse duhet të përditesohet.*<br><br>*Ref.7.4 Rregullore e Universitetit të Sporteve. Neni 87. Kuotat e pranimit.* |

| | |
|---|---|
| | *Ref.6. Rregullore e programit te Studimit MSH në Aktivitet Fizik dhe Shëndet:*<br>*Ref.8. Rregullore e FVFR*<br>*Ref. 17. Percjcllje e kritereve të pranimit n& ciklin e dyte te, stdimeve Master Shkencor, në FVFR* |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | Për të garantuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie, në fund të çdo viti kalendarik, Departamenti duhet të propozonte ndryshime të mundshme në përmbajtjen e programit të studimit, me qëllim përmirësimin dhe përditësimin për vitin akademik pasardhës. *Megjithatë, këto propozime nuk janë të pasqyruara si dhe nuk ka dokumentacion të programve në gjuhën angleze.*<br><br>*Ref.7.4 Rregullore e Universitetit të Sporteve. Neni 75.*<br>*Ref.6. Rregullore e programit te Studimit MSH në Aktivitet Fizik dhe Shëndet:*<br>*Ref.8. Rregullore e FVFR* |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit është i strukturuar në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar nga njësia përgjegjëse, duke përfshirë module të balancuara, praktikë profesionale dhe përshkrim të detajuar të ngarkesës mësimore. Rregullorja është në përputhje me aktet normative dhe përmban dispozita për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Programet mësimore janë të mirëpërcaktuara dhe ofrojnë informacion të plotë për studentët. Megjithatë, pavarësisht kërkesave për përmirësim të vazhdueshëm, nuk janë bërë propozime të reja për përmbajtjen e programit, dhe mungon dokumentacioni në gjuhën angleze.*<br>*GVB rekomandon që Departamenti të zbatojë në mënyrë sistematike procesin e rishikimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së programit në fund të çdo viti akademik. Gjithashtu, duhet të sigurohet dokumentacioni i plotë i programit në gjuhën angleze për të përmbushur standardet e transparencës dhe ndërkombëtarizimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

**Standardi II.4**

**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Programi i studimit është strukturuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ky program Master dyvjeçar përbëhet nga 120 kredi (ECTS).<br>Plani mësimor i programit është i përbërë nga leksione, seminare, përmbajtja e veprimtarive, laboratorë dhe praktika. Shpëmdarja dhe emërimi i lëndëve, sipas shpërndarja e lëndëve dhe kategorive, në lëndë bazë, karakterizuese ndërdisiplinore, praktikave, mundësojnë, plotësuese dhe formuese, japin mundësi në thellimin e njohurive thellim të njohurive dhe dhe aftësive praktike për punësim, ose studime të mëtejshme.<br><br>*Ref.3. Plani Strategijik FVFR 2021-2026, Misioni*<br>*Ref.4 Plani Strategjik UST 2021-2026. Objektivat*<br>*Ref.A.2 Studimi i Tregut t punës.* |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | Të gjitha lëndët e ofruara në këtë program synojnë të ndihmojnë studentët në zgjerimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive të nevojshme për tregun e punës. Bazuar në intervistën e zhvilluar, ky kriter konsiderohet i përmbushur.<br><br>*Ref. 5. VKM Nr.41, date 24.01.2018, "Per elementet e programeve te studimit te ofruara nga IAL.*<br>*Ref.14. Plani mësimor MSH në "Aktivitet Fizik dhe Shëndet"* |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | Sipas Planit Mësimor dhe intervistës së zhvilluar, ngarkesa mesatare është 60 kredi në vit, përafërsisht 30 ECTS për semestër, me një kohëzgjatje normale prej 15 javësh për semestër.<br>Programi i studimit, si në formë ashtu edhe në përmbajtje, është i përafruar me programet e institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri por nuk ka pësura ndryshime që nga momenti i licensimit të tij nga Ministria e Arsimit.<br><br>*Ref. 5. VKM Nr.41, date 24.01.2018, "Per elementet e programeve te studimit te ofruara nga IAL*<br>*Ref.14. Plani mësimor MSH në "Aktivitet Fizik dhe Shëndet"* |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe | Siç evidentohet në planin e mësimdhënies, përmbajtja teorike dhe praktike e lëndëve ndihmon studentët të përvetësojnë njohuri dhe |

| | |
|---|---|
| raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | aftësi të transferueshme, si dhe kompetenca të nevojshme për zhvillimin profesional. Ndarja e lëndëve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike dhe praktike. Kriteri përkatës, sipas intervistës së zhvilluar, është i përmbushur.<br><br>*Ref. 5. VKM Nr.41, date 24.01.2018, "Per elementet e programeve te studimit te ofruara nga IAL.*<br>*Ref.14. Plani mësimor MSH në "Aktivitet Fizik dhe Shëndet";*<br>*Ref.8. Rregullore e FVFR, objektiva* |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Programi Master i Shkencave (MSc) është në përputhje me objektivat e ciklit të dytë të studimeve dhe siguron përvetësimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave përkatëse. *Megjithatë, nuk ka të dhëna për përditësimin e Syllabuseve të lëndëve në fillim të çdo semestri nga stafi akademik, në përputhje me procedurat për ndryshimet në kurrikulë.*<br><br>*Ref.14. Plani mësimor MSH në "Aktivitet Fizik dhe Shëndet";*<br>*Ref. 20. Dosja e Program/Syllabus* |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Bazuar në objektivat e programit, përmbajtja e tij synon formojë profesionistë të aktivitetit fizik dhe shëndetit të cilët me njohuritë e tyre do të jenë lider të ardhshëm në në fushën e e sportit dhe edukimit shëndetësor.<br><br>*Ref.14. Plani mësimor MSH në "Aktivitet Fizik dhe Shëndet";*<br>*Ref. 20. Dosja e Program/Syllabus* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Përmbajtja e programit të studimit promovon mundësi të mëtejshme të studimit dhe/ose punësimin e studentëve në përputhje me pritjet dhe kërkesat e tregut të punës<br>Zyra e ish-studentëve ofron mbështetje dhe informacion mbi mundësitë e punësimit apo të avancimit në karrierë. *Megjithatë, nga dosja e vetëvlerësimit nuk rezultojnë prova të mjaftueshme që departamenti ka marrë në konsideratë propozimet e partnerëve për zhvillimin e programit.*<br>Studentët që përfundojnë programin Master i Shkencave (MSc) kanë të drejtë të ndjekin studimet doktorale. Kjo e drejtë konfirmohet nga të dhënat e intervistës së zhvilluar.<br><br>*Ref.14. Plani mësimor MSH në "Aktivitet Fizik dhe Shëndet"*<br>*Ref. 20. Dosja e Program/Syllabus*<br>*Ref.4.2. Studimi i tregut punes* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *Programi Master i Shkencave (MSc) është i strukturuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet akademike në fuqi. Ai ofron 120 ECTS në dy vite studimi, duke kombinuar teori dhe praktikë nëpërmjet leksioneve, seminareve, laboratorëve dhe praktikave profesionale. Programi është i përafruar me modelet kombëtare, dhe përmban elementë që zhvillojnë aftësitë e studentëve për punësim dhe studime të mëtejshme, përfshirë ciklin e tretë. Sipas intervistave të zhvilluara dhe analizës së planit mësimor, kriteret kryesore për përmbajtjen, ngarkesën akademike dhe kompetencat e fituara konsiderohen të përmbushura. Megjithatë, nuk ka evidenca të mjaftueshme për përditësimin e rregullt të syllabuseve në fillim të çdo semestri dhe nuk ka dokumentim të qartë që tregon përfshirjen e sugjerimeve të partnerëve në zhvillimin e programit.*<br>*GVJ rekomandon që duhet të forcohet procesi i rishikimit periodik të syllabuseve në përputhje me ndryshimet në kurrikulë dhe të dokumentohet përfshirja aktive e partnerëve të jashtëm në zhvillimin dhe përmirësimin e programit. Kjo do të sigurojë një përshtatje më të mirë me tregun e punës dhe zhvillimet akademike bashkëkohore* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të | Për të përmirësuar programin e studimit dhe për të përmbushur orët e praktikës të parashikuara në kurrikulë, Fakulteti mban kontakte me partnerë nga tregu i punës. *Megjithatë, nuk ka prova konkrete që dëshmojnë përfshirjen apo propozimet e këtyre partnerëve dhe bashkëpunëtorëve në rishikimin apo zhvillimin e programit të studimit në përputhje me nevojat reale të tregut.*<br><br>*Ref.2. Statuti i Universitetit te Sporteve. Misioni, Neni 5, Neni 4, Neni 10, (Njesite perberesete Universitetit te Sporteve)*<br>*Ref. 20.Dosjae Program/Syllabus* |

| | |
|---|---|
| tjerë nga tregu i punës. | |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | UST përfshin studentët në diskutime lidhur me përmirësimin e programit të studimit, duke i konsideruar ata aktorë të rëndësishëm në këtë proces.<br>Fakulteti gjithashtu ruan komunikimin me studentët e diplomuar, të cilët vlerësohen si një burim i vlefshëm për ofrimin e sugjerimeve në rishikimin periodik të programit.<br><br>*Ref.14. Plani mësimor MSH në "Aktivitet Fizik dhe Shëndet"*<br>*Ref.6. Rregullore e programit te Studimit MSH në Aktivitet Fizik dhe Shëndet:*<br>*Ref.8.4 Rregullore e FVFR. neni 53. Kuotat e Pranimit.*<br>*Ref. 17. P&rcjellje e kritcreve të pranimit në ciklin c dytë tëstudimeveMaster Shkencor, në FVFR.* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | Nga takimet e zhvilluara me drejtuesit dhe stafin akademik, angazhimi i tyre në institucionet apo organizatat sportive, ka ndihmuar gjithashtu institucionin të sjellë eksperiencat më të mira dhe të reflektojnë në programin e studimit eksperienca të ndryshme që vijnë nga aplikimi real i njohurive në fushën e aktivitetit fizik she shendetit.<br>*Megjithatë, nuk ka evidenca që tregojnë përshtatjen apo akreditimin e një programi të veçantë në lidhje me një fushë specifike kërkimore nga ana e institucionit.*<br><br>*Ref.4.Plani Strategjik UST2021-2026, Objektivat;*<br>*Ref.4.1 Plani Strategiik UST 2021-2025, Objektivat, Kerkimi Shkencor.* |
| **Konkluzione** | *Fakulteti ka krijuar lidhje me tregun e punës dhe përfshin studentët e tanishëm dhe të diplomuar në procesin e përmirësimit të programeve të studimit. Megjithatë, mungojnë prova konkrete për përfshirjen e partnerëve të tregut në rishikimin apo zhvillimin e kurrikulës, si dhe për përshtatjen e programeve me fusha specifike kërkimore. Gjithashtu, megjithëse stafi akademik ka eksperiencë praktike në institucione sportive, këto përvoja nuk dokumentohen qartë si pjesë e zhvillimit të programit.*<br>*GVJ rekomandon forcimine bashkëpunimit formal me partnerët e tregut të punës, duke siguruar dokumentim dhe përfshirje të drejtpërdrejtë të tyre në rishikimin e programeve. Po ashtu, institucionit i nevojitet të zhvillojë mekanizma të qartë për integrimin e fushave kërkimore dhe për dokumentimin e ndikimit të* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *përvojave praktike të stafit në përmirësimin e kurrikulës.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi II.6**<br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | Programi i studimit Master i Shkencave (MSc) është në përputhje me objektivat e njësisë bazë akademike.<br>Programi i studimit është hartuar për t'i pajisur studentët me njohuri të avancuara profesionale në fushën e aktivitetit fizik dhe shëndetit, ndërsa synon të përmirësojë aftësitë praktike në këtë fushë, programi synon gjithashtu të ofrojë informacion teorik të gjerë e të mjaftueshëm, duke promovuar kërkimin shkencor, i cili ndihmon studentët e interesuar të ndjekin programe të tjera studimi të ciklit të tretë.<br><br>*Ref.6. Rregullore e program t te Studimit MSH ne Aktivitet Fizik dhe Shëndet:*<br>*Ref.14. Plani mësimor MSH në "Aktivitet Fizik dhe Shëndet":* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | UST garanton dhe respekton lirinë akademike. Bazuar në objektivat e përcaktuara nga Departamenti, në fillim të çdo viti akademik, ngarkesa e lëndëve, kërkimi shkencor dhe detyra të tjera, i ndahen stafit akademik. Lëndët e shpërndara për personelin akademik janë në përputhje me ekspertizën e tyre profesionale dhe interesin kërkimor. *Megjithatë, nuk ka një raport periodik për raportimin e veprimtarisë kërkimore shkencore të njësisë kryesore/bazë sipas përcaktimeve tëVKM nr. 165, datë 21.03.2018 "Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë".*<br><br>*Ref.6. Rregullore e program t te Studimit MSH ne Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti*<br>*Ref.14. Plani mësimor MSH në "Aktivitet Fizik dhe Shëndet"*<br>*Ref.4 Plani Strategjik UST 2021-2026. Objcktivat*<br>*Ref.4.1. Plani Strategiik UST 2021-2025, Objektivat, Kerkimi Shkencor.* |
| **Kriteri 3.** Programi i | Programi synon të inkurajojë dhe motivojë studentët të |

| | |
|---|---|
| studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Njësia bazë nxit studentët të jenë pjesëmarrës në konferenca, seminare dhe workshope si dhe të angazhohen në studime, projekte dhe aktivite kërkimore, nëpërmjet detyrave të kursit, dhe hartimit të temave të ndryshme kërkimore. Sipas rregullores së Fakultetit, studenti ka të drejtë të përdorë, sipas rregullave përkatëse, të gjitha mundësitë dhe pajisjet që ofron LAL për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor. *Megjithatë, mungojnë evidenca që vërtetojnë përfshirjen konkrete të studentëve të këtij programi në projekte apo punë kërkimore.* Gjithashtu, nevojitet një angazhim më i madh për krijimin e bashkëpunimeve me partnerë ndërkombëtarë, me qëllim përmirësimin e kapaciteteve kërkimore dhe shkencore të programit të studimit.<br><br>*Ref.6. Rregullore e program t te Studimit MSH ne Aktivitet Fizik dhe Shëndet:*<br>*Ref.14. Plani mësimor MSH në "Aktivitet Fizik dhe Shëndet"* |
| **Kriteri 4.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. | Njësia bazë mbështetet financiarisht nga Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL), por fondet e alokuara për veprimtari kërkimore shkencore janë të pamjaftueshmedhe ajo nuk mund t'i administrojë vetë të ardhurat nga aktivitete tëndryshme.<br>Për këtë arsye duhen të intensifikuar përpjekjet për të siguruar burime shtesë financimi, përfshirë fondet nga donatorë të jashtëm.<br><br>*Rer.16. Mbi miratimin e propozimi per detjimin e te ardhurave.*<br>*Vendim Senati Nr. I date 05.01.2024 Per miratimin e propozimit perdetajimit te grantit te mesimdhenies per vitin 2024 te UST.*<br>*Ref. I6.I. Vendim Qarkullues Nr. 01 date 05. 01. 202 4 "Miratimine detajimit te grandit te mesimdhenies per Vitin Akademik 2024 ne UST"*<br>*Ref.28. Pasqyrat Financiare Vjetore.Te dhenat Tabelore.*<br>*Ref. 37. Percjellje e raportit vjetor 2023, ne nivel Rektorati* |
| **Konkluzione** | *Programi Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", është në përputhje me objektivat e njësisë akademike dhe synon të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike në fushën e aktivitetit fizik dhe shëndetit. Promovohet kërkimi shkencor dhe përfshirja e studentëve në aktivitete kërkimore përmes lëndëve, projekteve dhe konferencave. Gjithashtu, respektohet liria akademike si dhe ngarkesat e stafit është në përputhje me ekspertizën e tyre. Megjithatë, mungojnë evidenca për përfshirjen* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *konkrete të studentëve në projekte kërkimore, bashkëpunimet ndërkombëtare janë të kufizuara, dhe fondet për kërkim shkencor mbeten të pamjaftueshme.*<br>*GVJ rekomandont rritjen e përfshirjes aktive të studentëve në projekte kërkimore përmes dokumentimit të pjesëmarrjes së tyre dhe krijimit të mekanizmave nxitës. Po ashtu, duhet të intensifikohen përpjekjet për ndërtimin e partneriteteve ndërkombëtare dhe sigurimin e fondeve shtesë për kërkimin shkencor, përmes aplikimeve në projekte ndërkombëtare dhe bashkëpunimeve me donatorë të jashtëm.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi II.7**<br>**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave tëprogramit të studimit në kërkim shkencor. | Bazuar në të dhënat e plota mbi kualifikimet akademike dhe aktivitetet kërkimore të stafit akademik gjatë katër viteve të fundit, ky kriter konsiderohet i përmbushur.<br><br>*Ref.29. Kalendari i aktiviteteve ndër vite FVFR.*<br>*Ref,34 Tabele përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit (tab 5);*<br>*Ref.36 Relacion i aktivitetit të zyrs së këshillimit dhe karrieres.* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | Institucioni mbështet zhvillimin e kërkuesve të rinj, duke i inkurajuar dhe ndihmuar ato të marrin pjesë me projekte në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.<br><br>*Ref.40 Projekte të fituara në nivel departamenti nga anatërat e saj dhe përfshirja e studentëve në projekte. "Ndimi i aktivitetit fizik dhe në mirëqënien sociale dhe shëndetin mendor të të rinjve 1 6 - 1 8 vje¢"*<br>*Ref.40.1 Projektet e fituara nga Universiteti nga AKKSHI*<br>*Ref.23.8.Tedhëna tabelore per pjesëmarrjen në projektekërkimoreshkencore, staf dhe personel akademik.*<br>*Ref.26. Mbi miratimin e projekteve shkencore per vitin akademik2023-2024.* |
| **Kriteri 3.** Në fushën e | Njësia kryesore/bazë organizon konferenca në bashkëpunim me |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423
E-mail: info@ascal.al
Web site: www.ascal.al

| | |
|---|---|
| programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. | partnerë vendas dhe ndërkombëtarë, me synim mbështetjen e stafit dhe studentëve në përmbushjen e objektivave akademike dhe kërkimore.<br>Përveç konferencave, dëshmi të mëtejshme të angazhimit shkencor dhe akademik përfshijnë organizimin dhe pjesëmarrjen në trajnime, programe të lëvizshmërisë dhe leksione të hapura me lektorë të ftuar.<br><br>*Ref.2. Statuti i Universitetit të Sporteve, Misioni, Neni 5.*<br>*Ref .2. I. Statuti i Universitetit të Sporteve. Neni 4*<br>*Ref. 4. I. Plani Strategiik UST 2021-2025. Objektivat. Kërkimi Shkencor.* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. | GVJ konstaton se programi i studimit krijon mundësi për studentët të fitojnë aftësi konkurrues ne fushën e aktivitetit fizik dhe të shëndetit duke i bërë ata të aftë për tregun kombëtar dhe të përshtatshëm të punojnë në institucione publike dhe jopublike.<br><br>*Ref.33 TE dhëna tabelore pr c i lësinë në hyrje dhe dalje të studentëve;*<br>*Ref. 35. Te dhena tabelore per punesimit http://alumnni.ust.edu.al/*<br>*Ref .36. Relacion i aktivitetit te zyres se keshillimit dhe karrieres* |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës. | **N/A** |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (*p.sh. Professional QualificationsDirective, 2005/36/EU*). | **N/A** |

| | |
|---|---|
| **Konkluzione** | *Bazuar në të dhënat mbi kualifikimet dhe aktivitetet kërkimore të stafit akademik gjatë pesë viteve të fundit, kriteri për cilësinë e stafit konsiderohet i përmbushur. Institucioni mbështet zhvillimin e kërkuesve të rinj përmes pjesëmarrjes në konferenca dhe bashkëpunimeve kombëtare e ndërkombëtare. Organizohen konferenca, trajnime, programe lëvizshmërie dhe leksione të hapura me lektorë të ftuar, çka tregon një angazhim të qëndrueshëm akademik dhe shkencor. Gjithashtu, programi i studimit ofron mundësi për zhvillimin e aftësive konkurruese të studentëve në fushën e aktivitetit fizik dhe shëndetit.* <br> *GVJ rekomandon që institucioni të vazhdojë dhe të forcojë më tej mbështetjen për kërkuesit e rinj dhe përfshirjen e studentëve në aktivitetet shkencore. Gjithashtu, vlerësohet si e rëndësishme rritja e dokumentimit dhe matjes së ndikimit të këtyre aktiviteteve në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe punës kërkimore. Krijimi i një strategjie afatgjatë për mobilitet ndërkombëtar dhe për integrimin në rrjete kërkimore do të ishte një hap i mëtejshëm pozitiv.* |

| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1** <br> **Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, | Të gjitha format e mësimdhënies dhe të mësimnxënies: si leksionet, seminaret, praktikat, projektet dhe detyrat e kursit janë të përfshira në kurrikulën e studimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ndërthurja e teorisë me praktikën në |

| | |
|---|---|
| seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | pothuaj të gjitha lendët/modulet e formimit bazë dhe specifik përfshirja e studentëve dhe marrja e mendimeve, tyre, mundëson realizimin me sukses të veprimtarive të parashikuara.<br><br>*Ref.2. Statuti i Universitetit teSporteve.*<br>*Ref.6. Rregullore e programit tëStudimit MSH në AktivitetFizik dhe Shëndet;*<br>*Ref.7. Rregullore e Universitetit të Sporteve*<br>*Ref.8. Rregullore e FVFR-s;*<br>*Ref. 9. Rregullore e DLSH.* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Stafi akademik i përgjigjet diversitetit të studentëve përmes metodave alternative dhe fleksibile të mësimdhënies. Çdo syllabus përmban të gjitha specifikimet e parashikuara në VKM. 41/2018, i ndryshuar, përfshire format e msimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit të njohurive. Ngarkesa mësimore është shpërndarë në mënyrë të tillë që të mundësojë ngarkesë normale giatë gjithë vitit e përballueshme nga studentët. Stafi respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.<br><br>*Ref. 5.VKM Nr.41, date 24.01.2018. "Per elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL.*<br>*Ref. 20. Dosja e Program/Syllabus*<br>*Ref.22. Model Programi i Lëndës Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | UST mbështet zhvillimin profesional të stafit, duke ofruar kushte për përdorimin e metodave pedagogjike bashkëkohore. Në mbështetje të personelit akademik, institucioni prej disa vitesh ka vënë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. GVJ konstatoi se aktualisht UST ka në përdorim platformën e korrigjimit të provimeve Clean Score në bashkëpunim me AADF.<br><br>*Ref. 23. Te dhëna tabclore për personelin akademik në Njësinë Kryesore dhe Njësinë përgjegjëse;*<br>*Ref.23.1. Te dhëna tabelore për personelin akademik në programine studimit.*<br>*Ref23.2. Te dhena tabelore per ngarkesen e personelit ne programin e studimit n& MSH "Aktviteti Fizik dhe Shendeti.* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik | Në programet MSc, stafi demonstron kompetencë në përcjelljen |

| | |
|---|---|
| i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.<br>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | e njohurive përmes metodave të përshtatura sipas lëndës. Mësimi zhvillohet në mënyrë interaktive, duke inkurajuar përfshirjen aktive dhe autonominë e studentëve. Eksperienca shumëvjecare e personelit akademik është e ndërthurur me personelin e ri duke mundësuar në këtë mënyrë vijueshmëri të traditës së krijuar por njëkohësisht implementimin e metodave të reja të mësimdhenies. Fakulteti dhe personeli akademik janë të angazhuar të sigurojnë infrastrukturën e duhur mësimore/laboratorike, tekstet mësimore dhe materiale të tjera ndihmëse në funksion të studentëve.<br><br>*Ref.21.1.CV e stafit akademik te programit te studimit;*<br>*Ref.21.2. CV e stafit ndihmes akademik.*<br>*Ref.23.4. Te dhena Tabelore per infrastrukturen: Laboratoret.*<br>*Ref.19. Lista e teksteve periodike ne Biblioteke;*<br>*Re.19.1. Manual per perdorimin e bibliotekes online ULibrary* |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Njësia bazë përmes kontrolleve të vazhdueshme, planit të aktiviteteve të personelit akademik dhe anketimeve të studentëve, në bashkëpunim edhe më njësitë e tjera të fakultetit, përmirësojnë format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike. Cilësia e mësimdhënies vlerësohet përmes auditimeve dhe anketave, *megjithatë mungon dokumentimi i përfshirjes së drejtpërdrejtë të sugjerimeve studentore në përmirësimin e programeve.*<br><br>*Ref.8. Rregullore e FVFR-es:*<br>*Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MSH në Aktivitet Fizik dhe Shëndet;*<br>*Ref.9. Rregullore e DLSH* |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.<br>Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe | Institucioni ka hartuar udhëzime të qarta për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, me qëllim përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor. Bazuar në të dhënat e mbledhura nga intervistat me studentët dhe stafin akademik, Universiteti i Sporteve të Tiranës realizon vlerësimin e performancës së stafit akademik përmes pyetësorëve të plotësuar nga studentët. Përveç kësaj, përdoret edhe modeli i performancës akademike si një instrument shtesë për vlerësim. Institucioni siguron përfshirjen e studentëve në mënyrë aktive në procesin periodik të vlerësimit të metodave të mësimdhënies, duke mundësuar reflektimin e mendimeve dhe përvojës së tyre në përmirësimin e praktikave pedagogjike.<br>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është përgjegjëse për |

| | |
|---|---|
| zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | vlerësimin periodik të performancës së stafit akademik dhe të programeve të studimit. Kjo njësi realizon vlerësime vjetore për stafin mësimdhënës, kërkimor dhe administrativ, duke u bazuar në standarde të miratuara dhe instrumente të strukturuara.<br>Një komponent i rëndësishëm i këtij procesi është plotësimi i formularit të vetëvlerësimit nga ana e stafit akademik, i cili kontribuon në një vlerësim më gjithëpërfshirës dhe objektiv të performancës individuale dhe institucionale.<br><br>*Ref.29. Kalendari i aktiviteteve FVFR;*<br>*Ref.25. Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit* |
| **Konkluzione** | *UST ka të integruara në kurrikulë të gjitha format e mësimdhënies dhe mësimnxënies (leksione, seminare, praktika, projekte, detyra kursi), duke kombinuar teorinë me praktikën dhe duke respektuar legjislacionin në fuqi. Stafi akademik përdor metoda fleksibile e të përshtatura për diversitetin e studentëve, dhe çdo syllabus përmban specifikimet e kërkuara nga VKM nr. 41/2018. Ngarkesa mësimore është e balancuar, ndërsa institucioni mbështet zhvillimin profesional të stafit dhe përdor platforma teknologjike për vlerësim të drejtë e transparent (p.sh. Clean Score). Në programet MSc, mësimi është interaktiv, duke nxitur autonominë e studentëve. Fakulteti siguron infrastrukturë, tekste e materiale ndihmëse dhe përmirëson metodat në bazë të kontrolleve periodike, anketave dhe planeve të punës. Megjithatë, mungon dokumentimi i qartë për përfshirjen e drejtpërdrejtë të sugjerimeve studentore në përmirësimin e programeve. Vlerësimi i stafit bëhet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përmes standardeve, instrumenteve të strukturuara dhe formularëve të vetëvlerësimit.*<br>*GVJ rekomandon se duhet dokumentuar procesi i përfshirjes së sugjerimeve të studentëve në përmirësimin e programeve dhe metodave të mësimdhënies, duke krijuar një mekanizëm formal për ndjekjen dhe evidentimin e tyre. Kjo do të rrisë transparencën, dhe do të mundësojë përmirësime më të qëndrueshme në cilësinë e arsimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.2** |
|---|

| Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Bazuar në intervistat me studentët dhe stafin akademik, vlerësimi i aftësive profesionale dhe metodave të testimit në këtë program studimi është i përcaktuar në Rregulloren dhe syllabuset e Programit. Studentët informohen për këto metoda në fillim të çdo lënde.<br><br>*Ref.8. Rregullore e FVFR-es;*<br>*Ref.6. Rregulloreeprogramittë StudimitMSH në Aktivitet Fizikdhe Shendet:*<br>*Ref. 9 Rregullore e DLSH* |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Sipas Rregullores së FVFR dhe Rregullores së Masterit Shkencor, në fillim të çdo kursi studentët njihen me mënyrat e vlerësimit të kompetencave profesionale dhe aftësive kërkimore, të cilat zbatohen në përputhje me parashikimet përkatëse.<br><br>*Ref.6. Rregullore e programitte Studimit MSHnë Aktivitet FizikdheShëndet;*<br>*Ref.8.3 Rregullore eFVFR- s,neniKoordinatori i Programit* |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Sipas rregullores së programit të studimit, testimi i dijeve dhe njohurive të studentëve gjatë nje semestri ose viti akademik realizohet përmes detyrave të kursit, projekteve, punëve laboratorike, praktikës profesionale, provimeve të ndërmjetme dhe provimin përfundimtar. Vlerësimi dhe shpërndarja e pikëve brenda lendës/modulit bëhet është kompetencë e pedagogut prgjegjës të lendës dhe bëhët sipas modelit të detajuar nga departamenti. Gjithashtu, provimi përfundimtar ai organizohet sipas specifikave të lëndes dhe në bashkëpunim me të gjithë anëtarët e departamentit.<br><br>*Ref.8.5. RregutloreeFVFR- s,neni 48, rregallore e provimeve*<br>*Ref.32 Rregullore e Diplomimit. Neni 4.* |
| **Konkluzione** | *Mënyrat e vlerësimit përcaktohen nga rregulloret dhe syllabuset përkatëse. Studentët njihen që në fillim me kriteret, të cilat përfshijnë detyra, projekte, laboratorë, praktikë, provime të ndërmjetme dhe përfundimtare. Vlerësimi bëhet nga pedagogu i lëndës sipas udhëzimeve të departamentit, ndërsa provimi* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *përfundimtar organizohet në bashkëpunim me departamentin. Megjithatë, për të rritur transparencën dhe efektivitetin, sugjerohet që kriteret e vlerësimit të pasqyrohen në mënyrë të qartë dhe të jenë të aksesueshme gjatë gjithë semestrit,* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Testimi dhe vlerësimi i kompetencave profesionale dhe aftësive kërkimore realizohen përgjatë gjithë vitit akademik, me qëllim nxitjen e angazhimit të vazhdueshëm të studentëve në procesin mësimor, sigurimin e një vlerësimi objektiv dhe evidentimin e progresit individual. Ky vlerësimi reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.<br><br>*Ref.8. Rregullore e FVFR-es;*<br>*Ref.6. Rregullore e programit të Studimit MSH në Aktivitet Fizik dhe Shëndet;*<br>*Ref. 9Rregullore e DLSH* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Institucioni disponon aktualisht platformen Clean Score për testim dhe vlerësim elektronik. Për të garantuar integritetin e procesit dhe për të parandaluar çdo formë abuzimi, testimet administrohen në mënyrë të koduar.<br><br>*Ref.27. http://ustedual/programi-i- transparences// Programi i Transparences per Universitetin e Sporteve te Tiranes.*<br>*Ref.27.1.http://ustedual/politikat-e-privatesise//*<br>*Ref.7. Te dhena Tabelore per Bashkepunimet. Bashkepunimi me AADF per korrigjimin elektronik. (Tabela nr 5).* |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Testimi përfundimtar i kompetencave dhe aftësive profesionale organizohet nga komisione provimi, të përbëra në përputhje me kërkesat e rregullores në fuqi. Procesi i testimit me shkrim është anonim dhe monitorohet kryesisht nga stafi akademik; në raste të veçanta përdoren edhe mjete të mbikëqyrjes elektronike. |

| | |
|---|---|
| | *Ref.8.5 Rregullore e FVFR- es. neni 48, rregullore e provimeve:*<br>*Ref.30.1. Udhezues per perdorimin e sistemit Pitagora;*<br>*Ref.I2. Model Teze e Provimi* |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Çdo akt vlerësimi i realizuar nga personeli akademik duhet të shoqërohet me komentet përkatëse sqaruese, në funksion të transparencës dhe orientimit akademik të studentit.<br><br>*Ref.8.5 Rregullore e FVFR- es, neni 48, rregullore e provimeve;*<br>*Ref.30.1.Udhezues per perdorimin e sistemit Pitagora:*<br>*Ref.32Rregullore e Diplomimit, Neni 4* |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Të gjithë anëtarët e stafit akademik dhe studentët e institucionit kanë detyrimin të respektojnë standardet e integritetit akademik dhe kulturën e të mësuarit me ndershmëri. *Aktualisht, mungon një sistem formal për zbulimin dhe parandalimin e rasteve të plagjiaturës.*<br><br>*Ref.8.5 Rregullore e FVFR, neni 48, rregullore e provimeve*<br>*Ref.30.1. Udhezues per perdorimin e sistemit Pitagora:*<br>*Ref.32 Rregullore e Diplomimit. Neni 4.*<br>*Ref.8.6 Rregullore e FVFR-Es, Neni 87. Komisioni i provimeve* |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Rezultatet e vlerësimit të kompetencave dhe aftësive profesionale publikohen në kohën e përcaktuar dhe bazohen në kritere të qarta meritokracie dhe transparence.<br><br>*Ref.8.5 Rregullore e FVFR- es. neni 48. rregullore e provimeve;*<br>*Ref.30.1. Udhezues per perdorimin e sistemit Pitagora:*<br>*Ref.32 Rregullore e Diplomimit, Neni 4.*<br>*Ref.8.7 Rregullore e FVFR- es. neni 9I, Ankimimi* |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Institucioni garanton të drejtën e studentit për t'u njohur me procedurat e ndjekura gjatë vlerësimit dhe për të paraqitur kërkesë për rishqyrtim. Në rast paraqitjeje të një kërkese me shkrim nga ana e studentit, përgjegjësi i njësisë bazë kryen verifikimin përkatës dhe ndërmerr masat e nevojshme, sipas rastit.<br><br>*Ref.8.6 Rregullore e FVFR- es, Neni 87. Komisioni i provimeve:*<br>*Ref.8.8 Rregullore e FVFR-es, Neni 90. Rezultatet e provimeve.* |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga | Studenti ka të drejtë të kërkoj rishikim të testit nga një komision tjetër i cili ngrihet me propozim të përgiegjësit të departamentit |

| | |
|---|---|
| komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | dhe që miratohet nga Dekani i Fakultetit pasi analizon pretendimet dhe argumentet. Mbas kësaj etape, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit në systemin Pitagora dhe në sekretarinë mësimore.<br><br>*Ref.8.5 Rregullore e FVFR- es, neni 48, rregullore e provimeve:*<br>*Ref.30.1. Udhezues per perdorimin e sistemit Pitagora:*<br>*Ref.8.7 Rregulloree FVFR- es, neni 91, Ankimimi.* |
| **Konkluzione** | *Vlerësimi i studentëve bëhet gjatë gjithë vitit akademik për të nxitur angazhimin dhe për të siguruar objektivitet. Përdoret platforma Clean Score dhe procesi është i koduar e anonim. Vlerësimi bazohet në meritokraci dhe transparencë, dhe studenti ka të drejtë të kërkojë rishikim të notës.*<br>*Aktualisht, mungon një sistem formal për zbulimin dhe parandalimin e rasteve të plagjiaturës.*<br>*GVJ rekomandon që institucioni të marrë në konsideratë krijimin i një sistemi funksional për zbulimin dhe parandalimin e plagjiaturës, përmes përdorimit të programeve të njohura antiplagjiaturë në mënyrë që të forcohet integriteti akademik dhe të sigurohet origjinaliteti i punimeve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.4**<br>**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. | Bazuar në planin mësimor dhe syllabuset e lendëve, programi i studimit kombinon në mënyrë të balancuar komponentët teorike dhe praktikë për të garantuar thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësitë profesionale si dhe të veçanta shkencore të studentëve. Në planin shkencor, programi ndihmon studentët e interesuar që të ndjekin programet e ciklit pasardhës sic është programi i doktoraturës. Për sa i përket perspektivës së karrierës, studentët që përfundojnë me sukses programin marrin suportin e nevojshëm nga Zyra e Karrierës për tu njohur me intitucione që |

| | |
|---|---|
| | ofrojnë pozicione pune në fushën e aktivitetit fizik dhe shëndetit.<br><br>*Ref.6. Rregullore e programit të Studi m i t MSH në Aktivitet Fizik dhe Shëndeti;*<br>*Ref.14. Plani mësimor MSH në Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti:*<br>*Ref.29. Kalendari i aktiviteteve FVFR (2023-2024)*<br>*Ref.36 Relacion i aktivitetit të zyrës së këshillimit dhe karrierës* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Përfshirja në programin e studimeve MSc e lëndëve që lidhen me teknologjinë e informacionit, shkencat humane, shkencat sociale, etikën dhe komunikimin, ofron mundësinë për trajnim bazë në këto fusha. Programi mbulon gjithashtu njohuri në fushat biomjekësore, aktivitetin fizik, turizmin, kërkimin shkencor, menaxhimin e biznesit dhe shkencat sociale.<br><br>*Ref.5. VKM Nr.41. datë 24. 01.2018, "Per clementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL*<br>*Ref.23.5 Te dhena tabelore për elementët që përbëjnë planin mësimortë programit të studimit në MSH "Aktivitet Fizik dhe Shëndet*<br>*Ref. 24. Lista e Marrëveshjeve Ndërkombetare dhe Kombëtare* |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. | Në kuadër të programit të studimit dhe planeve mësimore të secilës lëndë, kompetencat dhe aftësitë e studentëve analizohen dhe rishikohen në përfundim të kursit. Gjithashtu, sipas intervistave me studentët dhe stafin akademik, gjatë javës së fundit të zhvillimit të lëndës, pedagogët i informojnë studentët për pikat kyçe mbi të cilat do të fokusohet vlerësimi në provimin përfundimtar.<br><br>*Ref.22. Model Programii Lendes Aktivitet Fizik dhe Shendet* |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në | Bazuar në CV-të dhe programet mësimore të stafit, rezulton se stafi akademik është i kualifikuar për ofrimin e lëndëve përkatëse. Stafi akademik gëzon të drejtën dhe aftësinë për të bashkëvepruar në mënyrë profesionale në interpretimin dhe zgjidhjen e çështjeve të caktuara. *Megjithatë, rekomandohet që institucioni të intensifikojë përpjekjet për përmirësimin e infrastrukturës sportive në mënyrë që studentëve t'u ofrohen kushte më të mira për zhvillimin e praktikës.*<br>Stafi akademik kombinon format e mësimdhënies me |

| | |
|---|---|
| interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | institucionet partnere për të mundësuar dhe rritur lëvizshmërinë e studentëve. UST ka nënshkruar marrëveshje për programin Erasmus+.<br><br>*Ref.36 Relacion i aktivitetit të zyrës së këshillimit dhe karrierës;*<br>*Ref.24. Lista c Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Kombëtare;*<br>*Ref.14. Plani mësimor MSH ne "Aktivitet Fizik dhe Shëndet:* |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Në varësi të fushës së veprimtarisë, personeli akademik organizon aktivitete ku përfshihen edhe studentë të cilet marrin pjesë në mënyrë interaktive. Megjithatë institucioni duhet të formalizojë organizimin e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar shqiptarë dhe të huaj, personalitetë të fushës së sportit dhe shëndetit.<br><br>*Ref.29. Kalendari i aktiviteteve FVFR (2023-2024)* |
| **Kriteri 6.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Stafi kontribuon në krijimin e një klime bashkëpunuese me studentët, duke nxitur zhvillimin e ideve inovative, kërkimeve të avancuara dhe aktiviteteve shkencore. Studentët mbështeten me bursa kur plotësojnë kushtet e përcaktuara në rregullore. Edhe ky aspekt është vlerësuar pozitivisht në bazë të intervistave të kryera.<br><br>*Ref.26. Mbi miratimin e projekteve shkencore për vitin akade mik 2023-2024.*<br>*Ref.36 Relacion i aktivitetit të zyrës se keshillimit dhe karrierës* |
| **Konkluzione** | *Analiza e mësipërme tregon se programi i studimit MSc është konceptuar në mënyrë të tillë që kombinon në mënyrë të balancuar komponentët teorikë dhe praktikë, duke pajisur studentët me një bazë solide njohurish dhe aftësish profesionale. Përfshirja e lëndëve ndërdisiplinore kontribuon në formimin e plotë akademik dhe profesional të studentëve, ndërsa stafi akademik përmbush përgjegjësitë e tij në nivel të kënaqshëm.*<br>*Megjithatë, për të përmirësuar më tej cilësinë e procesit mësimor dhe për të përmbushur standardet bashkëkohore të arsimit të lartë, rekomandohet: modernizimi i infrastrukturës sportive me qëllim rritjen e efikasitetit të pjesës praktike të procesit mësimor dhe përmirësimin e përvojës së studentëve në zhvillimin e aftësive profesionale; zgjerimi i bashkëpunimit me partnerë të rinj* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *ndërkombëtarë ku të synohet zgjerimi i bashkëpunimit me institucione të tjera të arsimit të lartë në Evropë dhe më gjerë, për të rritur mundësitë e shkëmbimit të studentëve dhe stafit; zhvillimi i rregullt i leksioneve të hapura dhe forumeve akademike me karakter shkencor dhe ndërdisiplinor, si pjesë integrale e formimit universitar dhe nxitjes së mendimit kritik.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike. | Bazuar në dokumentacionin e vetëvlerësimit dhe në Rregulloren e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe të Njësisë Kryesore institucioni ka hartuar një procedurë të qartë dhe të formalizuar për zhvillimin e provimit përfundimtar të studentëve dhe mbrojtjen e tezës së diplomës.<br><br>*Ref.7.5 Rregullore e Universitetit te Sporteve. Neni 107, rregullore diplomimi;*<br>*Ref.8.9 Rregullore e FVFR- es, neni 44. Kushtet e kalimit në vitin pasardhës dhe të diplomimit;*<br>*Ref.32 Rregullore e Diplomimit, Neni 4.* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. | Sipas intervistave të zhvilluara me studentët dhe stafin akademik, është evidentuar se departamenti bën publike listën e pedagogëve që u lejohet të mentorojë studentët gjatë procesit të përgatitjes së tezës. Gjatë këtij procesi, mentorët ofrojnë informacion, udhëzime metodologjike dhe mbështetje materiale të nevojshme për realizimin e temës së diplomës.<br>Në përputhje me Planin Mësimor të programit të studimit, mbrojtja e tezës përbën komponentin përmbyllës të ciklit të studimeve në nivelin Master. Kjo tezë përfaqëson një element thelbësor akademik, që synon të përmbledhë dhe të demonstrojë kompetencat e përftuara gjatë gjithë programit.<br><br>*Ref.7.5 Rregullore e Universitetit te Sporteve. Neni 107,* |

| | |
|---|---|
| | *rregullore diplomimi;*<br>*Ref.8.9 Rregullore e FVFR- s, neni 44, Kushtet e kalimit n~ vitin pasardh~s dhe t~ diplomimit;*<br>*Ref.32 Rregullore e Diplomimit. Neni 4.* |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | **N/A** |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Stafi akademik angazhohet në mënyrë aktive në orientimin e studentëve për përzgjedhjen dhe zhvillimin e temës së diplomës, duke garantuar përshtatshmërinë dhe nivelin shkencor të saj. Sipas intervistave të realizuara, ky kriter rezulton të jetë i përmbushur.<br><br>*Ref.7.5 Rregullore e Universitetit te Sporteve. Rregullore e Diplomimit*<br>*Ref.8.9 Rregullore e FVFR, neni 44. Kushtet e kalimit ne vitin pasardhës dhe të diplomimit:*<br>*Ref.32 Rregullore e Diplomimit. Neni 4.* |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Institucioni cakton mentorët që janë përgjegjës për mbështetjen e studentëve gjatë kryerjes së analizave, matjeve apo testimeve që lidhen me temën e tyre. Këta mentorë gjithashtu këshillojnë studentët të marrin pjesë në veprimtari kërkimore dhe akademike, duke i inkurajuar të integrojnë përvojat shkencore në përmbajtjen e tezës.<br>Udhëzimi për hartimin e tezës bazohet në udhëzime të miratuara nga institucioni, ndërsa mentorët sigurojnë cilësinë e përmbajtjes dhe vlefshmërinë e rezultateve. Vetëm pas verifikimit të përmbushjes së standardeve përkatëse, ata miratojnë dorëzimin e punës për mbrojtje përpara komisionit të diplomimit.<br><br>*Ref.7.5 Rregullore e Universitetit te Sporteve, Neni 107, rregullore diplomimi;* |

| | |
|---|---|
| | *Ref.8.9 Rregullore e FVFR- es, neni 44, Kushtet e kalimit në vitin pasardhës dhe të diplomimit*<br>*Ref.32 Rregullore e Diplomimit. Neni 4.*<br>*Ref. 41. Model Platforme e Temës së diplomës;*<br>*Ref.42 Model Kërkese e shfrytëzimit të laboratorëve për kërkimin shkencor nga studentët të shoqëruar me udhëheqësin.* |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Studentët e këtij programi përfundojnë studimet përmes mbrojtjes së një teze diplome, e cila vlerësohet me një notë përfundimtare nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.<br><br>*Ref.7.5 Rregullore e Universitetit te Sporteve, Neni 107, rregullore diplomimi*<br>*Ref.8. I0 Rregullore e FVFR-s. neni 71*<br>*Ref.32 Rregullore e Diplomimit, Neni 4.*<br>*Ref.43 Model vlerësimi i temës së diplomës.* |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në përfundim të ciklit të studimeve, studentët pajisen me diplomën dhe shtojcën përkatëse (Diploma Supplement), të licencuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.<br><br>*Ref.7.5 Rregullore e Universitetit te Sporteve, Nen i 107, rregullore*<br>*diplomimi*<br>*Ref.8. I 0 Rregul lore e FVFR- s, neni 71*<br>*Ref.32 Rregullore e Diplomimit, Neni .1.* |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Institucioni mban dhe arkivon dokumentacionin e studentëve sipas kërkesave ligjore. Sekretaria mësimore mban regjistrat bazë të studentëve me të dhëna personale të tyre, regjistrin themeltar, regjistrin e arritjeve akademike, si dhe regjistrin e lëshimit të diplomave të marra bashkë me suplementin e diplomës të formatuarasipas akteve nënligjore në fuqi.<br><br>*Ref.7.6 Rregullore e Universitetit te Sporteve, Neni 112 regjistrimi*<br>*i studentit*<br>*Ref.8.II Rregullore e FVFR-s. neni I5. Ruajtja e te dhenave dhe regjistrimi I studentit.* |
| **Konkluzione** | *Procesi i hartimit dhe mbrojtjes së tezës së diplomës është i strukturuar dhe përmbush standardet e kërkuara nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi. Roli i mentorëve dhe përfshirja e tyre aktive në mbështetjen e studentëve vlerësohet pozitivisht.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *GVJ rekomandon qëpër përmirësim e mëtejshëm të standarteve duhet të forcohet lidhja me kërkimin shkencor institucional duke krijuar mekanizma që nxisin integrimin e tezave të diplomës me projektet kërkimore të departamenteve dhe qendrës shkencore brenda institucionit si dhe të digjitalizohet procesi i dorëzimit dhe arkivimit të tezave duke krijuar një sistem elektronik për dorëzimin, ruajtjen dhe menaxhimin e tezave të diplomës, i cili do të sigurojë akses më të lehtë, transparencë dhe ruajtje afatgjatë të materialeve akademike si dhe kontroll antiplagjoiaturë.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.6**<br>**Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | **N/A** |
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | **N/A** |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë | **N/A** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | | | | |
| **Konkluzione** | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | Nuk përmbush et | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, | GVJ, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur nga Institucioni UST, gjatë vizitës në institucion, si dhe nga bisedat me stafin drejtues përkatës, konstatoi për vitin akademik 2024-2025, që personeli akademik, i cili është i gjithë me kohë të plotë, ashtu si edhe personeli ndihmës, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, zotëron nivelin e dëshiruar profesional dhe akademik për përmbushjen me sukses të programit të Studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti".<br>Stafi akademik PAE dhe PAK i angazhuar në këtë program studimi, për tre vitet e fundit akademike, është si më poshtë: |

| Kualifikimi i stafit akademik të PS | **2022-2023** | | **2023-2024** | | **2024-2025** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | PAE | PAK | PAE | PAK | PAE | PAK |

<table>
<tr>
<td>natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</td>
<td>
<table>
<tr><td>Prof. Dr</td><td>4</td><td>0</td><td>4</td><td>0</td><td>3</td><td>0</td></tr>
<tr><td>Prof. Asoc.</td><td>9</td><td>0</td><td>10</td><td>0</td><td>9</td><td>0</td></tr>
<tr><td>Dr/Phd</td><td>7</td><td>1</td><td>6</td><td>1</td><td>7</td><td>0</td></tr>
<tr><td>Dr. Proc</td><td>2</td><td>0</td><td>2</td><td>0</td><td>2</td><td></td></tr>
<tr><td>Msc.</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td><td>0</td></tr>
<tr><td>Gjithsej</td><td>22</td><td>1</td><td>22</td><td>1</td><td>21</td><td>0</td></tr>
</table>
Mbulimi i lëndëve në përmbajtje të Kurrikulës ekzistuese, është në përputhje me kualifikimin e çdo pedagogu, sipas frymës së ligjit dhe rregulloreve përkatëse.
Ref.21.Formatii dosjes personale të stafit akademik<br>Ref.21.1.Cv e stafit akademik të programit të studimit<br>Ref.21.2.Cv e stafit ndihmë akademik<br>Tabelat 6.1, 6.2, 6.3 Anek Tabelat permbledhese
</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</td>
<td>
GVJ, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur nga Institucioni UST, gjatë vizitës në institucion, si dhe nga bisedat me stafin drejtues përkatës, konstatoi që personeli akademik, i cili është i gjithë me kohë të plotë, në gjithë veprimtarinë e tij akademike dhe institucionale, është i bazuar korrektësisht dhe në përputhje të plotë me kornizën ligjore në fuqi. Ngarkesa e orëve mësimor për stafin e programit, mbulohet 100% nga stafi akademik efektiv.
Ref.21.Formatii dosjes personale tëstafit akademik<br>Ref.21.1.Cv e stafit akademik të programit të studimit<br>Ref.21.2.Cv e stafit ndihmë akademik
</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</td>
<td>
GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin e paraqitur nga Institucioni UST, gjatë vizitës në institucion, si dhe nga bisedat me stafin drejtues përkatës, konstatoi që Personeli akademik që realizon programin e Studimit Master i Shkencave në “Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti” është i qëndrueshëm për gjithë periudhën e akreditimit të këtij programi, e pasqyruar kjo në kontratat e punësimit që mbulojnë sigurime shoqërore dhe shëndetësore për stafin aktiv në program.
Ref.21.1.Cv e stafit akademik të programit të studimit<br>Ref.40.Projekte të fituara nënivel departamenti.<br>Ref.40.1.Projekte të fituara nga UST dhe nga AKSHI
</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | *Ref.43.Mobilitete hyrëse dhe dalësenëUST-në Tiranë* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me stafin drejtues, konstatuam që procedura e rekrutimit, ndiqet dhe zbatohet rigorozisht nga hallkat përgjegjëse, me synim përzgjedhjen e stafit të ri, me nivelin e dëshiruar të kualifikimit, që përputhet me natyrën, strukturën dhe modulet lëndore që ata do mbulojnë. Vlerësimi i kandidaturave është bërë nga një komision ad hoch, i përbërë nga 5 persona, pa konflikt interesi me konkurruesit.<br>Personeli Akademik, është mbështetur nga këto kritere:<br>- Plotësimi i kritereve të përgjithshme, 20% e vlerësimit.<br>- Plotësimi I kritereve specifike, 40% e vlerësimit.<br>- Plotësimi i kritereve preferenciale, 10% të vlerësimit<br>- Performanca në intervistë, 30% të vlerësimit.<br>Dokumentacioni i vëzhguar nga GVJ, e pasqyronte saktë zbatimin e standardit ligjor.<br><br>*Ref.21.Formati i dosjeve personale të stafit akademik*<br>*Ref.21.1. Cv e stafit akademik të programiit të studimit* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me stafin drejtues, konstatuam që DLSH, i cili përgjigjet për zbatimin me sukses të programit të Studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", ka në dispozicion personel ndihmës akademik, që shërben brenda Departamentit për mirëmbajtjen e paisjeve moderne laboratorike, të cilat rezultojnë të mjaftueshme për mbarëvajtjen e suksesin e programit të studimit.<br><br>*Ref.21.1.Cv e stafit akademik të programit të studimit*<br>*Ref.21.2. Cv e stafit ndihmës akademik të programit të studimit.*<br>*Ref.14 Plani Mësimor MSH "Aktivitet fizik dhe shendet"* |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të | GVJ, mbështetur në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me stafin drejtues, konstatuam që DLSH, i cili përgjigjet për zbatimin me sukses të programit të Studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", administrata përgjegjëse si zyra e personelit akademik dhe ndihmës akademik dhe zyra e arshivës, ka ruajtur mbledhur dhe përditësuar të dhëna që lidhen me personelin akademik dhe ndihmës akademik, që |

| | |
|---|---|
| personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | realizon programin e studimit.<br>Personeli dorëzon në Zyren e Burimeve Njerëzore edhe materiale plotësuese, që lidhen me aktivitetin dhe angazhimet dhe që sherbejnë për analiza më të hollësishme në lidhje me performancën.<br><br>*Ref.18. Model i analizës vjetore të DLSH-së*<br>*Ref.18.1.Model i analizës vjetore të FVFR*<br>*Ref.37.Përcjellje Raporti Vjetor 2023 në nivel rektorati* |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me stafin drejtues, konstatoi që DLSH, i cili përgjigjet për zbatimin me sukses të programit të Studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", kanë hartuar kontrata dhe programe bashkëpunimi me IAL, me Federatat e ndryshme sportive si dhe me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, ku studentë kryejnë praktikat në terren si dhe ndihmohen të mbledhin material didaktik, për përgatitjen e punimit të diplomës si dhe veprimtari të tjera, që parasheh programi i studimit.<br><br>*Ref.24.Lista e marrveshjeve ndërkombëtare dhe kombëtare*<br>*Ref.24.1. Marrëveshje bashkëpunimi me Federatën Shqiptare të Futbollit*<br>*Ref.25. Raporti i përfitimeve nga Marrveshjet e Bashkëpunimeve* |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | **N/A** |
| **Konkluzione** | *Nga shqyrtimi i RVB-së dhe takimet fizike, konstatuam se, në fillim të semestrit, studenti, në bashkëpunim me pedagogun e praktikës, përcaktuar me vendim departamenti, përzgjedh institucionin në të cilin do të zhvillojë praktikën, përcaktojnë objektivat për t'u përmbushur gjatë gjithë periudhës së praktikës.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Objektivat e përcaktuar shkruhen në aneksin e marrëveshjes me institucionin pritës. Në aneks përshkruhen gjithashtu, përshkrimi i punës, përgjegjësitë dhe detyrimet e studentit.*<br>*Pedagogu i praktikës do të takojë studentin dhe përfaqësuesin e praktikës gjatë periudhës së praktikës. Studenti, nga ana e tij, mund të kërkojë takime të tjera veç atyre të parashikuara me pedagogun kur ai ka ndonjë problem ose nevojë për ndihmë. Në fund të praktikës studenti dorëzon raportin e praktikës. Vlerësimi është procedura që kryhet pas praktikës:*<br>• *Raportin e praktikës realizuar nga studenti.*<br>• *Vlerësimin sipas formatit standard nga mbikëqyrësi i institucionit pritës.*<br>*Vlerësimi i pedagogut të praktikës* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | GVJ, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë inspektimit dy ditor në ambientet sportive dhe zyrat e UST-së si dhe takimet me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", konstaton UST ka vënë në shërbim të përmbushjes së programit të studimit, mjedise të mjaftueshme si në aspektin sportive (fusha sportive të mirëmbajtura dhe të mirë pajisura me mjete didaktike të kohës, terrene sportive, nga të cilët një në ndërtim e sipër, palestra të lojërave me dorë, palestër gjimnastike, laboratorë modern, të përfituar nga projekte ndërkombëtare si **Projekti SPEED,** etj.<br>Sallat e leksioneve janë të bollshme dhe të mirë pajisura.<br>Nga biseda me studentet, mësuam se një pjesë e pajisjeve kompjuterike, kanë nevojë të rinovohen.<br>GVJ, ia përcolli stafit drejtues te njësisë administrative këtë shqetësim dhe kërkesë të studentëve.<br><br>*Ref.23.6.Të dhëna Tabelore për infrastrukturën mbështetëse për* |

| | |
|---|---|
| | *procesin mësimor.Mjediset e Fakultetit/Njesia Bazë tabela 16.* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | GVJ, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë inspektimit dy ditor në ambientet, auditorët, dhe zyrat e UST-së si dhe takimet me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", konstatoi që UST ka vënë në shërbim të përmbushjes së programit të studimit, mjedise të mjaftueshme si në aspektin sportiv (fusha sportive të mirëmbajtura dhe të mirë pajisura me mjete didaktike të kohës, terrene sportive, nga të cilët një në ndërtim e sipër, palestra të lojërave me dorë, palestër gjimnastike, laboratorë modern, të përfituar nga projekte ndërkombëtare si Projekti SPEED, etj.)<br>Sallat e leksioneve janë të bollshme dhe të mirë pajisura.<br>Nga biseda me studentet, mësuam se një pjesë e pajisjeve kompjuterike, kanë nevojë të rinovohen.<br><br>*Ref.28. Info mbi laboratorët në UST-Manual Pdf*<br>*Ref.23.6.Të dhëna Tabelore për infrastrukturën mbështetëse për procesin mësimor.Mjediset e Fakultetit/Njesia Bazë tabela 16.* |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | GVJ, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë vizitës në ambientet, auditorët, dhe zyrat e UST-së si dhe takimet me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", konstatoi që UST ka vënë në shërbim të përmbushjes së programit të studimit, laboratorë modern, me aparatura që ndihmojnë studentët të eksperimentojnë, masin dhe vlerësojnë të dhënat e tyre të vjelura nga puna kërkimore e shkencore në terren.<br>Spikat Laboratori i Elektronikës, me aparaturat kryesore të Leonardo Mechanogrph (GFRP), Poltrona e Matjes së Forcës- "EasTech",<br>Sistemi i Shtrojave, MEDIZINTECHNIK Gmbh,"BROHUER TIMING SYSTEMS" etj.<br><br>*Ref.28. Info mbi laboratorët në UST-Manual Pdf*<br>*Ref.23.6.Të dhëna Tabelore për infrastrukturën mbështetëse për procesin mësimor.Mjediset e Fakultetit/Njesia Bazë tabela 16.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, | GVJ, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë vizitës në ambientet, auditorët, dhe zyrat e UST-së si dhe takimet me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", |

| | |
|---|---|
| të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | konstatoi që UST ka vënë në shërbim të përmbushjes së programit të studimit, laboratorë modern, me aparatura që ndihmojnë studentët të eksperimentojnë, masin dhe vlerësojnë të dhënat e tyre të vjelura nga puna kërkimore e shkencore në terren.<br>Spikat Laboratori i Elektronikës, me aparaturat kryesore të Leonardo Mechanogrph (GFRP), Poltrona e Matjes së Forcës- "EasTech",<br>Sistemi i Shtrojeve, MEDIZINTECHNIK Gmbh,"BROHUER TIMING SYSTEMS" etj.<br>Mjediset e UST-së, mbulohen me wifi pë stafin, administratën dhe studentët, plus rrjetit të brendshëm institucional.<br><br>*Ref.28. Info mbi laboratorët në UST-Manual Pdf.*<br>*Ref.19.Lista e texteve periodike në bibliotekë*<br>*Ref.19.1. Manual përdorimi i bibliotekës Online U- Librari*<br>*Ref.23.6.Të dhëna Tabelore për infrastrukturën mbështetëse për procesin mësimor.Mjediset e Fakultetit/Njesia Bazë tabela 16.* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | Gjatë vizitës në UST, GVJ pa nga afër gjithë praktikën shkresore, të manifestuar në rregulloren e UST-së, në Relacionin e infrastrukturës në rregulloret përkatëse, FVFR përveç kapaciteteve të brendshme të mjaftueshme, bashkëpunon me IAL dhe federatat sportive, për marrjen e kontributit të specialistëve më të mire në shërbim të studentëve.<br>Të gjitha këto mundësi të ofruara, janë plotësisht të mjaftueshme për mbarëvajtjen me sukses të praktikës mësimore dhe praktikës profesionale të studentëve.<br>Nëpërmjet hartave kadastrale, pasqyrohet qartë dhe saktë struktura dhe përmbajtja e mjediseve që institucioni zotëron dhe vendos në shërbim të Programit të Studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti".<br><br>*Ref.3. Rregullore e UST-së (neni 115)*<br>*Ref.39. Relacioni i Infrastrukturës së UST-së Ref.23.6.Të dhëna Tabelore për infrastrukturën mbështetëse për procesin mësimor.Mjediset e Fakultetit/Njesia Bazë tabela 16.*<br>*Ref.24.Lista e marrveshjeve ndërkombëtare dhe kombëtare*<br>*Ref.24.1. Marrëveshje bashkëpunimi me Federatën Shqiptare të Futbollit*<br>*Ref.25. Raporti i përfitimeve nga Marrveshjet e Bashkëpunimeve* |
| **Konkluzione** | *Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *se institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në bashkëpunim edhe me IAL dhe federatat kombëtare sportive.* <br> *Gjithashtu, konstatojmë se institucioni ka kapacitetet e duhura infrastrukturore dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve në këtë program studimi, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3** <br> **Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Gjatë vizitës në UST, GVJ pa nga afër gjithë praktikën shkresore, të manifestuar në rregulloren e UST-së, në Relacionin e infrastrukturës, në rregulloren e praktikës mësimore dhe praktikës pedagogjike dhe posaçërisht vizita në mjediset e Bibliotekës së UST-së, konstatuam qartësisht se studentët mbulohen me literaturën e nevojshme Digjitale dhe Fizike, në funksion përmbushjes së kërkesave të programit të studimit. <br><br> *Ref.11. Funksioni i Bibliotekës/ Infrastruktura* <br> *Ref.22.Model Programi i Lëndës Aktivitet Fizik dhe Shendet* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | GVJ, nga vizita në mjediset e Bibliotekës së UST-së, konstatuam qartësisht se studentët mbulohen me literaturën e nevojshme Digjitale dhe Fizike, në funksion përmbushjes së kërkesave të programit të studimit dhe se njësia përgjegjëse, e ka në vëmendje të punës së saj, përditësimin e literaturës me botime të 5 viteve të fundit, e cila është manifestuar në rinovimin e literaturës në ciklin e leksioneve të pedagogëve, duke përfituar nga mundësia e ndryshimit të deri 20% të programit. <br><br> *Ref.11. Funksioni i Bibliotekës/ Infrastruktura* <br> *Ref.14. Plani Mësimor MSHnë Aktivitet Fizik dhe Shëndet* <br> *Ref.20.Dosja e Program/Syllabusi* |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve | GVJ, nga vizita në mjediset e Bibliotekës së UST-së, konstatuam qartësisht se studentët mbulohen me literaturën e nevojshme |

| | |
|---|---|
| bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Digjitale dhe Fizike, në funksion përmbushjes së kërkesave të programit të studimit dhe se njësia përgjegjëse, e ka në vëmendje të punës së saj, përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit, e cila është manifestuar në rinovimin e literaturës në ciklin e leksioneve të pedagogëve.<br>Biblioteka e UST-së, është tërësisht në shërbim të studentëve si në aspektin e shfrytëzimit fizik të literaturës, ashtu edhe në aspektin digjital, nëpërmjet Katalogimit të Përbashkët COBISS.<br>Biblioteka ka në fondin e saj botime të rreth 65 viteve histori sportive dhe botime shkencore serioze.<br><br>*Ref.11. Funksioni I Bibliotekës/ Infrastruktura*<br>*Ref.19.Lista e Teksteve Periodike në Bibliotekë.*<br>*Ref.19.1.Manual për përdorimin e Bibliotekës Online U-Librari* |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | GVJ,bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë vizitës në ambientet, auditorët, zyrat e UST-së, në mjediset e Bibliotekës, si dhe takimet me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti",konstatoi që Fondi Fizik i Bibliotekës, përfshin libra dhe revista shkencore, tekste bazë dhe tekste ndihmës, e mjaftueshme për të mbuluar gjithë veprimtarinë mësimore brenda programit të studimit.<br>Fondi fizik i librave nisur nga titujt është afërsisht 1546 tituj. Llogaritur në fashikuj ky numër është shumë herë më i lartë. Njëherazi, në fondin fizik të bibliotekës së UST-së, përfshihen me dhjetëra Disertacione të mbrojtura në vite, si dhe një numër i lartë i Mikrotezave, që i ndihmojnë studentët të gjejnë materiale të vlefshme për kërkimin shkencor.<br>Kërkohet që në vazhdim ky numër të vijë duke u rritur sepse vizioni i specialistit të lëvizjes, krijohet që në auditorët e tanishëm.<br>Në shërbim të studentëve është edhe katalogimi elektronik me linkun: https://ulibrary.rash.al/<br><br>*Ref.11. Funksioni i Bibliotekës//Infrastruktura Ref.19.Lista e Teksteve Periodike në Bibliotekë.*<br>*Ref.19.1.Manual për përdorimin e Bibliotekës Online U-Librari*<br>*Ref.29. Model Programi/Syllabi me Update të Literaturës.* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa | GVJ, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë inspektimit dy ditor në ambientet, auditorët, zyrat e UST-së, në mjediset e Bibliotekës, si dhe takimet me stafin drejtues dhe |

| | |
|---|---|
| pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", konstatoi se Fondi i Bibliotekës, paraqitet në bazë të të dhënave elektronike, përmes regjistrimeve në Sistemin e Katalogimit të përbashkët COBISS.al dhe krijon kushte shfrytëzimi të barabartë dhe pa pagesë extra, për të gjithë studentët e përfshirë në programin e studimit.<br><br>*Ref.11. Funksioni i Bibliotekës / Infrastruktura (ebsco.com academic libraries)*<br>*Ref.19.1.Manual për përdorimin e Bibliotekës Online U-Librari Sistemin e Katalogimit të përbashkët COBISS.al* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | GVJ, gjatë vëzhgimit dhe monitorimit, në mjediset e Bibliotekës së UST-së,konstatoi se Fondi i Bibliotekës, paraqitet në bazë të të dhënave elektronike, përmes regjistrimeve në Sistemin e Katalogimit të përbashkët COBISS.al dhe krijon kushte shfrytëzimi të barabartë dhe pa pagesë extra, për të gjithë studentët e përfshirë në programin e studimit.<br>Biblioteka është e mirë pajisur me mjete teknike që mundësojnë studentët të përfitojnë pa kufizim, shërbime për të cilat ata interesohen.<br><br>*Ref.11. Funksioni i Bibliotekës//Infrastruktura*<br>*Sistemi i Katalogimit të përbashkët COBISS.al*<br>*Ref.39. Relacioni i Infrastrukturës së UST-së Ref.23.6.Të dhëna Tabelore për infrastrukturën mbështetëse për procesin mësimor.Mjediset e Fakultetit/Njesia Bazë tabela 16* |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | GVJ, gjatë vëzhgimit dhe monitorimit, në mjediset e Bibliotekës së UST-së, konstatoi se mbështetur në rregulloren e Bibliotekës, Biblioteka punon nga e hëna në të premte, nga ora 08 deri ora 20.00, në përgjigje të procesit mësimor dhe më tej. Gjatë inspektimit që zhvilluam aty si GVJ, sfida është të rritet qasja e numrit të studentëve me Bibliotekën, akoma dhe më tej. Nga takimi me studentët, konstatuam se për autorë shumë të njohur në fushën e tyre, kur u pyetën nga ana jonë, nuk kishin dijeni, kur në fakt, këta autorë ne i gjetëm në raftet e Bibliotekës gjatë inspektimit që zhvilluam aty si GVJ.<br><br>*Ref.19.2.Rregullore e Bibliotekës së UST-së*<br>*Ref.19.3.Kartela personale e përdoruesit* |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të | GVJ, gjatë vëzhgimit dhe monitorimit, në mjediset e Bibliotekës së UST-së, konstatoi se Mbështetur në rregulloren e Bibliotekës, |

| | |
|---|---|
| programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Biblioteka kryen veprimtari që përgatit dhe shpërndan informacion bibliotekar dhe informacion bibliografik<br>Biblioteka i është drejtuar me një shkresë Departamentit dhe Departamenti, në mënyrë të detajuar, i dërgoi stafit të Bibliotekës, listën më titujt përkatës që u siguruan nga stafi Bibliotekës.<br>Biblioteka bën shkëmbim dhe huazim ndër bibliotekar në shërbim të studentëve të anëtarësuar.<br>Vendos në shërbim të të anëtarësuarve, koleksionet e Bibliotekës në sallat e leximit, ose i huazon ato kur është e nevojshme.<br>Biblioteka u krijon kushte të antarësuerve të fotokopjojnë materiale deri në 15-20 faqe,duke respektuar të drejtën e autorit dhe rregulloren.<br>Të dhënat mbi fondin e Bibliotekës dhe pasurimin e këtij fondi si dhe njoftimet që lidhen me veprimtarinë e Bibliotekës, janë të pasqyruara në website-in e UST-së.<br><br>*Ref.11. Funksioni i Bibliotekës//Infrastruktura*<br>*Sistemi i Katalogimit të përbashkët COBISS.al*<br>*Ref.19.4. Fondi i Bibliotekës së UST-së* |
| **Konkluzione** | *Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se, Biblioteka ka një fond të pasur fizik dhe elektronik me tekste mësimore në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra dhe revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e kurseve dhe veprimtarive mësimore të programit Programin e Studimit të Ciklit të Dytë Master Shkencor në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti"*<br>*Rekomandohet pasurimi i bibliotekës në fondin shqip të librit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me | GVJ, bazuar RVB, në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë vizitës në ambientet, auditorët, zyrat e UST-së, në mjediset e Bibliotekës, si dhe takimet me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", konstatoi që Institucioni |

| | |
|---|---|
| studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional RASH/Pitagora. UST dhe njësitë kryesore të tij, kanë ndërtuar dhe mirëmbajnë faqen zyrtare të internetit<br><br>*Ref.11. Funksioni i Bibliotekës//Infrastruktura*<br>*Ref.30.Udhëzues për përdorimin e Pitagora*<br>*Ref.40. Marrëveshja RASH/Pitagora* |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | GVJ, bazuar RVB, në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë vizitës në ambientet, auditorët, zyrat e UST-së, në mjediset e Bibliotekës, si dhe takimet me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", konstatoi që Institucioni me anë të Postës Elektronike, menaxhon dhe administron aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, personelit administrativ, duke zbatuar kriterin e ruajtjes së privatësisë. etj. GVJ, e konfirmoi këtë standard, gjatë vizitës në Zyrën e Personelit të UST-së dhe në Zyrën e arshivës.<br><br>*Ref.2. Statuti I UST-së Kapitulli VI (neni 70.)*<br>*Ref.11. Funksioni i Bibliotekës//Infrastruktura*<br>*Ref.40. Marrëveshja RASH/Pitagora* |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | GVJ, në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë vizitës në ambientet, auditorët, zyrat e UST-së, në mjediset e Bibliotekës, si dhe takimet me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", konstatoi që Institucioni me anë të Postës Elektronike, menaxhon dhe administron aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, personelit administrativ, duke zbatuar kriterin e ruajtjes së privacisë. etj.<br>GVJ, e konfirmoi këtë standard, gjatë vizitës në Zyrën e Personelit të UST-së dhe në Zyrën e arshivës.<br><br>*Ref.2. Statuti I UST-së Kapitulli VI (neni*<br>*Ref.16.Linku (https:/fshl.ust.edu.al/master-i-shkencave/* |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik | GVJ, në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë vizitës në ambientet, auditorët, zyrat e UST-së, në mjediset e Bibliotekës, si dhe takimet me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", konstatoi që Institucioni me anë të Faqes Zyrtare dhe Postës Elektronike, mundëson qarkullimin e informacioni si dhe shkëmbimin interaktiv të informacionit, ndërmjet studentëve dhe |

| | |
|---|---|
| dhe studentëve. | personelit akademik. Institucioni ka të instaluar Platformën Pitagora( e-shërbime)<br><br>*Ref.2. Statuti I UST-së Kapitulli VI (neni 70.71)*<br>*Ref.16.Linku (https:/fshl.ust.edu.al/master-i-shkencave/* |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | GVJ, bazuar RVB, në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë vizitës në ambjentet, auditorët, zyrat e UST-së, në mjediset e Bibliotekës, si dhe takimet me grupin studentorë dhe stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", konstatoi që Institucioni me anë të Faqes Zyrtare dhe Postës Elektronike, mundëson qarkullimin e informacioni si dhe shkëmbimin interaktive të informacionit, ndërmjet studentëve dhe personelit akademik në çdo kohë dhe në kohë reale. Sistemi i menaxhimit të brendshëm e mundëson këtë standard komunikimi dhe raportimi me anë të Platformës PITAGORA (e-shërbime).<br><br>*Ref.2 Statuti I UST-së Kapitulli VI (neni 70.)*<br>*Ref.5. Rregullore e Sekretarisë*<br>*Ref.16.Linku (https:/fshl.ust.edu.al/master-i-shkencave/* |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | GVJ, gjatë vizitës në mjediset dhe zyrat e UST, e ndoqi nga afër plotësimin e këtij standardi dhe konstatoi se në përmbushje të rregullores, informacionet që lidhen me realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", personelin akademik, pasqyrimin e veprimtarive të ndryshme me rëndësi, janë të publikuara në faqen e websitit të UST-së, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.<br>Programi U-Transparencë është gjithashtu një tjetër mundësi që institucioni ofron informacion elektronik.<br><br>*Ref.27.http://ust.edu.al/programi-i-transparencës/ Programi i transparencës për Universitetin e Sporteve Tiranë (Ref.nr.48)*<br>*Ref.27.1.http://ust.edu.al/politikat-e-privatësisë/Politikat e Privatësisë* |
| **Konkluzione** | *Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet disa sistemeve, duke administruar të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Konstatojmë, gjithashtu, se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, në faqen e tyre zyrtare të web-it në gjuhën shqipe dhe* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *atë angleze, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | GVJ, bazuar RVB, në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë vizitës në ambjentet, auditorët, zyrat e UST-së, në mjediset e Bibliotekës, si dhe takimet me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", konstatoi që Institucioni ka hartuar një raport financiar të kostove të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit dhe mbështetjen financiare, sipas Udhëzimit të MASR nr.5, datë 19-2-2018 "Për përcaktimin e elementeve përbërës të raportit vjetor" I ndryshuar me Udhëzimin e MASR nr.24 datë21-10-2019<br><br>*Ref.44.Vendim Qarkullues Nr.01datë 05-01-2024"Miratimin e detajimiit të grandit të mësimdhënies për vitin akademik 2024 në UST*<br>*Ref.23.6.Të dhëna tabelore Tabelore për infrastrukturën mbështëtëse për procesin mësimorë.* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | GVJ, bazuar RVB, në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë inspektimit dy ditor në ambjentet, auditorët, zyrat e UST-së, në mjediset e Bibliotekës, si dhe takimet me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktivitet Fizik dhe Shëndet",konstatoi që Institucioni ka hartuar dhe ka vepruar në bazë të Projekt Buxhetit afatmesëm 2024-2026, në të cilin janë parashikuar fondet e nevojëshme për mbulimin financiar dhe buxhetor të shpenzimeve operative, shpenzimeve për mirëmbajtjen e mjediseve, mirëmbajtjen e bazës teknologjike, shpenzimet për Bibliotekën Online, detyrimet financiare përfshirë grantet e përfituara nga faktorë vendas apo të huaj.<br><br>*Ref.44.Vendim Qarkullues Nr.01datë 05-01-2024"Miratimin e detajimiit të grandit të mësimdhënies për vitin akademik 2024 në UST studimit Master i Shkencave në "*Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti*"*<br>*Ref.45.Programi Buxhetor Afatmesëm 2024-2026* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | GVJ, bazuar RVB, në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë vizitës në ambjentet, auditorët, zyrat e UST-së, konstatoi që Institucioni UST, mbështetur në Statutin, në vendimin e Senatit dhe në vendimin e Bordit të Administrimit, ka realizuar auditim periodik, me anë të të cilit, dokumenton dhe vlerëson gjendjen financiaredhe rrugët e përdorimit të tij.<br><br>*Ref.28.Pasqyrat Financiare Vjetore 2024, të dhënat Tabelore.*<br>*Ref.37.Përcjellje raporti vjetor për vitin 2024, në nivel Rektorati.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | GVJ, bazuar RVB, në gjetjet e evidentuara në përshkrimore, gjatë vizitës në ambjentet, auditorët, zyrat e UST-së, konstatoi që Institucioni UST, mbështetur në Statutin, në vendimin e Senatit dhe në vendimin e Bordit të Administrimit, Institucioni raporton në nivel Njësie Bazë (departamentit).<br>***GVJ, konstatoi dhe sugjeroi, që ndryshe nga praktika e ndjekur deri më sot, fondet duhet t'i shkojnë vetë departamentit dhe të shpenzohen për nevojat e vetë departamentit nga departamenti. Në këtë mënyrë rritet demokracia në Institucion dhe niveli i përgjegjesisë dhe i tranparencës financiare është më i dukshëm***. |

| | |
|---|---|
| | *Ref.37.Përcjellje raporti vjetor për vitin 2024, në nivel Rektorati.*<br>*Ref.17.Financat (Pasqyra Financiare)* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | GVJ, në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë viztës në ambientet, auditorët, zyrat e UST-së, konstatoi që Institucioni UST, mbështetur në Statutin, në vendimin e Senatit, në vendimin e Bordit të Administrimit dhe Ligjin e IAL, *(neni 49),* ka garantuar financim të qëndrueshëm të programit të studimit dhe rritjen e kuotës së financimit, në ato raste kur ka përmirësim të situatës financiar.<br>GVJ, konstatoi dhe sugjeroi, që ndryshe nga praktika e ndjekur deri më sot, fondet duhet t'i shkojnë vetë departamentit dhe të shpenzohen për nevojat e vetë departamentit nga departamenti!<br>Në këtë mënyrë rritet demokracia në Institucion dhe niveli i përgjegjësisë dhe transparenca financiare është më i dukshëm.<br><br>*Ref.37.Përcjellje raporti vjetor për vitin 2024, në nivel Rektorati*<br>*Ref.28.Pasqyrat Financiare Vjetore 2024, të dhënat Tabelore.* |
| **Konkluzione** | *Bazuar në RVB, institucioni harton buxhetin me baza vjetore. Ekziston një procedurë e brendshme e planifikimit të buxhetit. Institucioni ka një plan financimi i cili mbulon shpenzimet për shumë aspekte.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin | GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me grupin studentor, me stafin drejtues, konstatuam |

| | |
|---|---|
| e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | që Institucioni UST-në, bazuar në rregulloret e brendshme, në statutin dhe Ligjin e IAL, në përputhje të plotë më aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, ka hartuar dhe zbaton procedura të cilat e mbulojnë ciklin e plotë të ecurisë së studentëve, gjatë gjithë ciklit nga hyrja deri në diplomimin e tyre.<br><br>*Ref.1. Ligji I IAL (neni 25)*<br>*Ref.2. Statuti I UST-së (kreuVII)*<br>*Ref.3 Rregullore e UST*<br>***https://ust.edu.al/master-shkencor/*** |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me grupin studentor, me stafin drejtues të, konstatuam që Institucioni UST, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe me stafin drejtues, është në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, ka hartuar dhe zbaton procedura të cilat që sigurojnë dhe mbrojnë të drejtat e të gjithë studentëve të përfshirë në programin e studimit.<br><br>***https://ust.edu.al/master-shkencor/*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. | GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me grupin studentor, me stafin drejtues me stafin drejtues, konstatuam që Institucioni UST, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe përputhje të plotë më aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, ka hartuar dhe ka publikuar para vitit akademik, kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve.<br>Ne pamë konkretisht nga zyra e kurrikulave, praktikën shkresore dhe dokumentare, që ndjek Institucioni për këtë qëllim.<br><br>*Ref.2. Statuti i UST-së (kreuVII)*<br>***https://ust.edu.al/master-shkencor/*** |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe | GVJ, mbështetur në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me grupin studentor, me stafin drejtues, konstatuam që Institucioni UST, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe përputhje të plotë më aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, ka hartuar kritere, procedura të përzgjedhjes së studentëve, të vlerësimit të dijes dhe të diplomimit të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", janë të aksesueshme nga të interesuarit, përfshirë edhe publikun e gjerë. |

| | |
|---|---|
| të aksesueshme nga publiku. | *Ref.6.1.Rregullore e programit të studimit MSH në Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti.*<br>*Ref.7.7.Rregullore e Universitetit të Sporteve, Neni 60, Ktiteret e pranimit në MSH.*<br>*Ref.8.12.Regullore e FVFR-së, neni 667, Pranimet në ciklin e dytë të studimeve MSH.* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me grupin studentor, me stafin drejtues, konstatuam që Institucioni UST, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe përputhje të plotë më aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, (Rregullore e Departamentit, websiten e Institucionit) etj, informon të interesuarit që duan të ndjekin këtë program studimi, shoqëruar me kriteret përkatëse, përpara fillimit të çdo viti akademik.<br><br>*Ref.17.Përcjellja e kritereve të pranimit në Master Shkencor në ciklin e dytë të studimit.*<br>*Ref 177.1.Kuatat e propozuara dhe të miratuara të pranimit të studentëve 2022-2025.* |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me grupin studentor, me stafin drejtues, konstatuam që Institucioni UST, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe përputhje të plotë më aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, *(Ligji i IAL neni 25)* përcakton qartë qëndrimin e Institucionit, para çdo viti akademik, për personat kandidatë me nevoja të veçanta, si dhe të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.<br><br>*Ref.17.Përcjellja e kritereve të pranimit në Master Shkencor në ciklin e dytë të studimit.*<br>*Ref 177.1.Kuatat e propozuara dhe të miratuara të pranimit të studentëve 2022-2025.*<br>*Ligji I IAL neni 25* |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | GVJ, mbështetur në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me grupin studentor, me stafin drejtues, konstatuam që Institucioni UST, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe përputhje të plotë më aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, *(Ligji I IAL neni 25)* përcakton qartë qëndrimin e Institucionit, para çdo |

| | |
|---|---|
| | viti akademik, duke publikuar kriteret, në shërbim të kandidatëve që kërkojnë të vijnë në këtë program studimi nga shtete të tjera, jashtë Republikës së Shqipërisë.<br><br>*Ref 177.1.Kuatat e propozuara dhe të miratuara të pranimit të studentëve 2022-2025.*<br>*Ligji I IAL neni 25* |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me grupin studentor, me stafin drejtues, konstatuam që Institucioni UST, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe përputhje të plotë më aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, *(Tarifa e Studimit,Plani Strategjik I UST-së, Ligji I IAL-së)* etj, ka hartuar politika ndihmëse, si kuota për dhënie bursash, për shtresat në nevojë dhe studentët ekselentë.<br><br>*Ref.16.2.Vendimet e Bordit të Administrimit Janar - Gusht 2024, për bursat dhe mbështetjen për kategoritë e veçanta.* |
| **Konkluzione** | *Nga vizita në institucion dhe evidencat, konstatojmë se institucioni harton dhe publikon çdo vit akademik kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që ofron institucioni, sipas legjislacionit në fuqi dhe i publikon ato online ne faqen zyrtare të web-it.*<br>*Gjithashtu, konstatojmë se institucioni, ka hartuar politika të qarta për promovimin dhe informimin e kandidatëve për studentët si dhe ka hartuar politika mbështetëse për shtresa në nevojë duke dhënë bursa për to dhe studentët ekselentë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisAht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në | Gjatë vizitës në mjediset e UST-së, nga njohja dhe komunikimi me grupin studentor, me stafin drejtues si dhe bazuar në RVB, GVJ konstatoi se UST, mbështetur në aktet ligjore dhe nën |

| | |
|---|---|
| lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | ligjore në fuqi, ka vënë në shërbim të studentëve, informacion të mjaftueshëm, që lidhet me kriteret e konkurrimit, detyrimet studentore, ecurinë e procesit akademik në vijimësi dhe gjatë kapërcimit nga një vit akademik në vitin pas ardhës.<br>Studentët kanë në shërbim të informimit të tyre accountin e platformës PITAGORA, ku depozitohen dhe ruhen të dhënat akademike ndër vite.<br><br>*Ref.7.8 Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 81, 82.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Gjatë vizitës në mjediset e UST-së, nga njohja dhe komunikimi me grupin studentor, me stafin drejtues, si dhe bazuar në RVB, GVJ konstatoi se UST, mbështetur në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, ka vënë në shërbim të studentëve, informacion të mjaftueshëm, që lidhet me kriteret dhe procedurat ligjore që ndjek Institucioni, për njohjen e kualifikimeve të më parëshme si dhe studimeve të pjesshme, kur këto raste ndeshen në praktikë dhe në rastin e transferimeve.<br><br>*Ref.7.12.Ibid. Rregullore e UST-së mbi transferimet e studimeve, Neni 78.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Gjatë vizitës në mjediset e UST-së, nga njohja dhe komunikimi me grupin studentor, me stafin drejtues, si dhe bazuar në RVB, GVJ konstatoi se UST, mbështetur në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, ka vënë në shërbim të studentëve, të Programit të Studimit në Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti" informacion të mjaftueshëm, që lidhet me kriteret dhe procedurat ligjore që ndjek Institucioni, mbi procedurat e vlerësimit të studentëve gjatë ciklit të shkollimit, deri në diplomim. Informacion jepet edhe ditën e parë, për studentët që fillojnë rishtazi programin e studimit.<br><br>*Ref.7.9. Rregullore e Universitetit të Sporteve, Neni 103, Sistemi i Vlerësimit.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Gjatë vizitës në mjediset e UST-së, nga njohja dhe komunikimi me grupin studentor, me stafin drejtues, në RVB, GVJ konstatoi se UST, mbështetur në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, ka vënë në shërbim të studentëve, të Programit të Studimit në Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", informacion të mjaftueshëm, që lidhet me kriteret dhe procedurat ligjore që ndjek Institucioni, për informimin e studentëve mbi procedurat dhe kriteret e punimit të diplomës, caktimit dhe |

| | |
|---|---|
| | zgjedhjes së tematikës, caktimi i udhëheqësit shkencor, përzgjedhjes së literaturës etj.<br><br>*GVJ, la porosi që procedurat e punimit të temës së diplomës, të nisin më herët se deri më tani dhe mori mirëkuptimin e stafit.*<br><br>*Ref.10.Rregullore e Diplomimit, Neni 107* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Gjatë vizitës në mjediset e UST-së, nga njohja dhe komunikimi me grupin studentor, me stafin drejtues, si dhe bazuar në RVB, GVJ konstatoi se UST, mbështetur në aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, ka vënë në shërbim të studentëve, të Programit të Studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti" informacion të mjaftueshëm, që lidhet me përgatitjen dhe publikimin e udhëzuesve të posaçëm, duke organizuar takime të hapura, në shërbim të interesuarve për programin e studimit, si dhe duke i informuar ata për kohëzgjatjen, karrierën, rregulloren përkatëse, etj.<br><br>*Ref.2. Statuti i UST-së (Kreu VI, neni 70 dhe neni 75)* |
| **Konkluzione** | *Nga vizita në institucion dhe evidencat, takimet me studentët dhe pedagogët, konstatojmë që MSh në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", i detajuar me lëndët dhe modulet që përmban programi i studimit, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Nëpërmjet Rregullores së UST dhe Guidës së studentëve, përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe diplomimi, kriteret e aplikimeve, regjistrimeve dhe transferimeve, ku studenti gjen informacion të plotë për strukturat e UST dhe funksionet e tyre, si dhe orientohen në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të tyre.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët | GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u |

| | |
|---|---|
| informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me grupin studentor, me stafin drejtues, konstatuam që Institucioni UST, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe përputhje të plotë më aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, *(Rregullore e UST-së, Rregullore e FVFR-së, Rregullore e Departamentit) etj,* ka hartuar në dobi të studentëve,<br><br>*Ref.3. Rregullore e UST-së*<br>***http://fvfr.ust.edu.al/master-shkencor/*** |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me grupin studentor, me stafin drejtues, konstatuam që Institucioni UST, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe përputhje të plotë më aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, *(Rregullore e UST-së, Rregullore e FVFR-së, Rregullore e Departamentit)* etj, ka hartuar në dobi të studentëve, udhëzues të posaçëm, ku përfshihen lëndët, modulet, veprimtaritë formuese, që përbëjnë një informacion të vlefshëm për të interesuarit.<br><br>***http://fvfr.ust.edu.al/master-shkencor/*** |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me grupin studentor, me stafin drejtues, konstatuam që Institucioni UST, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe përputhje të plotë më aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, (Ligji IAL-së, Plani Strategjik i UST-së, Alumni), etj, ka hartuar në dobi të studentëve, informacion të orientimit të karrierës së tyre, mundësitë e punësimit dhe orientimin drejt tregut të punës.<br>Zyra e Këshillim, informimit dhe orientimit të Karrierës, së bashku me studentët, marrin pjesë në panairin e punës.<br>GVJ konstatoi gjatë seancës së komunikimit, se mjaft student njëherazi ishin edhe të punësuar, me kohë të plotë ose të pjesshme.<br><br>*Ref.35.Të dhëna Tabelore për punësimin e studentëve(ALUMNI) Pdf* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, | GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me grupin studentor, me stafin drejtues, konstatuam që Institucioni UST, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe përputhje të plotë më aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, *(Linku* |

| | |
|---|---|
| infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | *I Studentëve* (**https://ust.edu.al/studentët/**), në shërbim të mbarëvajtjes së procesit akademik mësimor, studentët janë informuar për infrastrukturën, sallat, palestrat, terrenet sportive etj, vend ndodhjen dhe përdorimin e tyre sipas programit.<br><br>*Linku I Studentëve (https://ust.edu.al/studentët/)* |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me grupin studentor, me stafin drejtues, konstatuam që Institucioni UST, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe në përputhje të plotë më aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, *(Statuti UST-së, rregullore e FVFR-së) etj*, janë në shërbim të mbarëvajtjes së procesit akademik mësimor, studentët janë informuar në lidhje me programin e studimit, përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit. Ky informacion është i arritshëm në distancë. Zyra IT pajis studentët me account personal në Platformën Pitagora, me anë të të cilit marrin akses lidhur me programin e studimit etj<br><br>*Ref. 2. Statuti UST-së*<br>*Ref.30.1.Udhëzues për përdorimin e Sistemit Pitagota.* |
| **Konkluzione** | *Nga vizita në institucion dhe shqyrtimi i evidencave, konstatohet që UST publikon një informacion të plotë për strukturat e UST-së dhe funksionet e tyre, departamentet e ndryshme, auditorët, sekretaritë mësimore, bibliotekën, laboratorët, sistemin elektronik, etj. Njësia e Karrierës dhe Alumnit informon dhe orienton studentët mbi mundësitë për tregun e punës si dhe i përfshin ata në aktivitete të ndryshme pedagogjike që institucioni organizon.*<br><br>*Rezulton se në çdo fillim të vitit akademik studentëve u prezantohen materiale si Rregullorja e Programit të Studimit MSh në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti" , ku përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe diplomimi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| |
|---|
| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të** |

| **hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me grupin studentor, me stafin drejtues, konstatuam që Institucioni UST, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe përputhje të plotë më aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, *(Sekretaria, Rregullore e funksionimit të brendshëm të sekretarisë mësimore),* ka mbajtur dhe ruajtur statistika gjithë vjetore, për numrin e studentëve, në Programin e Studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti".<br>Këtë fakt e prekëm konkretisht si GVJ, gjatë inspektimit në sekretarinë mësimore.<br><br>*Ref.13.(Sekretaria, Rregullore e funksionimit të brendshëm të sekretarisë mësimore)*<br>*Ref.33.Të dhëna tabelore përcilësinë në hyrjen dhe daljen e studentëve.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | GVJ, mbështetur në RVB, në dokumentacionin faktik që na u parashtrua nga zyrat përkatëse të administratës përgjegjëse si dhe nga takimet me grupin studentor, me stafin drejtues, konstatuam që Institucioni UST, bazuar në legjislacionin e brendshëm dhe përputhje të plotë më aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi, *(Sekretaria, Rregullore e funksionimit të brendshëm të sekretarisë mësimore),* ka mbajtur dhe ruajtur statistika gjithë vjetore, për numrin e studentëve në Programin e Studimit, Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeit".<br>Nuk na u paraqit asnjë rast, i tërheqjes nga program i studimit, apo largim para përfundimit të diplomës.<br>Këtë fakt e prekëm konkretisht si GVJ, gjatë inspektimit në sekretarinë mësimore.<br>Studentët për tre vitet e fundit akademike, sipas vizitës në sekretarinë mësimore, janë si më poshtë:<br>2022-2023 16 studentë<br>2023-2024 25 studentë<br>2024-2025 14 studentë<br><br>*Ref.13.Rregullore e brendshme e Administratës, Neni 9*<br>*Ref.13.(Sekretaria, Rregullore e funksionimit të brendshëm të* |

| | |
|---|---|
| | *sekretarisë mësimore)*<br>*Ref.33.Të dhëna tabelore për cilësinë në hyrjen dhe daljen e studentëve.* |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | GVJ, bazuar RVB, në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë vizitës në ambientet, auditorët, zyrat e UST-së, në mjediset e Bibliotekës, si dhe takimet me grupin studentorë, me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", konstatoi që Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të UST-së *(UMIS)* dhe me anë *të Postës Elektronike, (Rash/Pitagora),* ka menaxhuar dhe administron të dhëna të rëndësishme statistikore, të cilat ruajnë privacinë në bazë të ligjit, por ndërkohë janë të sigurta dhe plotësisht të verifikueshme.<br><br>*Ref.8.Rregullore e FVFR, Objektivat e FVFR*<br>*Ref.13.(Sekretaria, Rregullore e funksionimit të brendshëm të sekretarisë mësimore)*<br>*Marrëveshja RASH/Pitagora*<br>*(https://ust.pitagora.rash.al/login)* |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | GVJ, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë vizitës në ambientet, auditorët, zyrat e UST-së, në mjediset e Sekretarisë mësimore, si dhe takimet me grupin studentorë,me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", konstatoi që Institucioni me anë të Postës Elektronike, mbështetur në *Rregulloren e Sigurimin e Cilësisë* dhe kontributin e dhënë nga NJ.S.B.C-së ka menaxhuar dhe administron të dhëna të rëndësishme statistikore, të cilat ruajnë privacinë në bazë të ligjit, por ndërkohë janë të sigurta dhe plotësisht të verifikueshme për saktësinë e informacionit që mbajnë.<br><br>*Ref.8.Rregullore e FVFR-së.Objektivat e FVFR*<br>*Ref.18.Model Analize Vjetore të Departamentit të Lëvizjes dhe Shëndet Fizik.*<br>*Ref.18.1.Model Analize Vjetore FVFR*<br>*Ref.37.Përcjellje Raporti Vjetor për vitin 2023, në nivel Rektorati.* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të | GVJ, në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë vizitës në ambientet, auditorët, zyrat e UST-së, në mjediset e Sekretarisë mësimore, si dhe takimet me grupin studentorë, me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", konstatoi që Institucioni ka dokumentacion analitik, të sistemuar mirë dhe të skeduar me kujdes profesional, ku dokumentohet puna e Departamentit që ofron këtë program studimi, mbi nivelin në hyrje dhe në dalje të studentëve dhe masat e propozuara për ecurinë më të mirë të tyre.<br><br>*Ref.18.Model Analize Vjetore të Departamentit të Lëvizjes dhe Shëndet Fizik.*<br>*Ref.18.1.Model Analize Vjetore FVFR* | | | |
| **Konkluzione** | *Nga vizita dhe takimet në institucion, si dhe nga evidencat e shqyrtuara konstatohet që institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatare hyrëse dhe dalëse etj. Gjithashtu administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themeltar të studentëve, sipas legjislacionit në fuqi.*<br>*GVJ, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë vizitës në ambientet dhe zyrat e UST-së si dhe takimet me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti"shprehet se ky Standard Përmbushet Plotësisht.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | GVJ, bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore, gjatë vizitës në ambientet, auditorët, zyrat e UST-së, në mjediset e Sekretarisë mësimore, si dhe takimet me grupin studentorë,me stafin drejtues dhe menaxhues të programit të studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", konstatoi që Institucioni, mbështetur te Statuti UST-së dhe posaçërisht të Rregullore e DLSH-së, parasheh përfshirjen e studentëve, si nëpërmjet demokracisë së drejt për drejtë, ashtu edhe nëpërmjet nivelit të përfaqësimit, në organet këshilluese dhe vendimmarrëse |

| | |
|---|---|
| | të UST-së si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, NJSBC si në nivël UST-je edhe në nivël FVFR etj.<br><br>*Ref.2.5.Statuti i UST-së, Neni 96 dhe Neni 97*<br>*Ref.2.7.Statuti UST-së, Ibid, Neni 19, pika 3.ç.*<br>*Statuti UST-së, Ibid, Neni*<br>*Ref.2.8. Statuti UST-së, Ibid, Neni 30, pika 2.*<br>*Ref.2.9.Statuti UST-së, Ibid, Neni 29, pika 3.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Institucioni, mbështetur te Statuti UST-së dhe posaçërisht te Rregullore e FVFR-së, parasheh përfshirjen e studentëve, si nëpërmjet demokracisë së drejt për drejtë, ashtu edhe nëpërmjet nivelit të përfaqësimit, në organet këshilluese dhe vendimmarrëse të UST-së si senati, etj.<br>GVJ, pa konkretisht dokumentacionin (Rregullore e marrëdhënies me studentët si dhe Vendimin e KIZ mbi zgjedhjet studentore) ku pasqyrohej drejtë dhe saktë kjo praktikë, tregues i funksionimit demokratik institucional dhe dëgjim i zërit dhe kontributit studentor, nëpërmjet përfshirjes së tyre në forume dhe organizata si Senati UST-së, Alumni, etj.<br><br>*Në praktikën e punës së DLSH-së, një student përfshihet në grupin e punës, për rishikimin e programeve dhe syllabuseve.*<br>*Ref.37. Rregullore e marrëdhënies me studentët.*<br>*Ref.31. Model Pyetsori i Studentëve 2023*<br>*Ref.31.1.Model Raporti i Fokus Grupeve të Studentëve* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | Institucioni, mbështetur te Statuti UST-së dhe posaçërisht te Rregullore e FVFR-së, parasheh përfshirjen e studentëve, si nëpërmjet demokracisë së drejt për drejtë, ashtu edhe nëpërmjet nivelit të përfaqësimit, në organet këshilluese dhe vendimmarrëse të UST-së si senati, etj.<br>GVJ, pa konkretisht dokumentacionin *(Rregullore e marrëdhënies me studentët si dhe Vendimin e KIZ mbi zgjedhjet studentore)* ku pasqyrohej drejtë dhe saktë kjo praktikë, tregues i funksionimit demokratik institucional dhe dëgjim i zërit dhe kontributit studentor, nëpërmjet përfshirjes së tyre në forume dhe organizata si Senati UST-së, Alumni, ose marrja e kontributit të tyre nëpërmjet pyetësorëve, grupeve fokusimi, pjesëmarrjes në mbledhje të departamentit<br><br>*Ref.8. Rregullore e FVFR-s*<br>*Ref.8.1. Rregullore e FVFR-s, Neni 5* |

<table>
<tr><td colspan="1"></td><td colspan="4">Ref.8.2. Rregullore e FVFR-s, Neni 40<br>Ref.8.7. Rregullore e FVFR, Neni 91, Ankimimi.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</td><td colspan="4">Institucioni, mbështetur te Statuti UST-së dhe posaçërisht të Rregullore e FVFR-së, parasheh përfshirjen e studentëve, si nëpërmjet demokracisë së drejt për drejtë, ashtu edhe nëpërmjet nivelit të përfaqësimit, në organet këshilluese dhe vendimmarrëse të UST-së si senati, etj.<br>GVJ, pa konkretisht dokumentacionin, ku pasqyrohet drejtë dhe saktë kjo praktikë, tregues i funksionimit demokratik institucional dokumentar dhe shkresor.<br>Megjithëse , GVJ, gjatë komunikimit me studentët e Programit të Studimit Master i Shkencave në ”Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti”, një student shprehu pakënaqësi për saktësinë e vlerësimit, nga një pedagog, por nuk kishte ndjekur rrugën e ankimimit, parashikuar në rregullore, për arsye që nuk i cilësoi. Sigurisht, ky ishte vetëm një rast dhe nuk prek punën e mirë që bën njësia bazë, për barazinë dhe meritokracinë në vlerësim!<br><br>Ref.8. Rregullore e FVFR-s<br>Ref.8.1. Rregullore e FVFR-s, Neni 5<br>Ref.8.2. Rregullore e FVFR-s, Neni 40<br>Ref.8.7. Rregullore e FVFR, Neni 91, Ankimimi.</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">Bazuar në takimet në institucion dhe shqyrtimi i evidencave konstatohet që studentët e UST janë të përfshirë në vendimmarrje, këshillime dhe vlerësime mbi procesin akademik në organet kolegjiale të institucionit. Ata kanë përfaqësues në Senatin Akademik, në Bordin Administrativ dhe në Grupet e vlerësimit të brendshëm. Studentët kanë krijuar një numër të madh grupesh shoqërore për të menaxhuar më mirë jetën e tyre sociale dhe për të përmirësuar marrëdhëniet me njëri tjetrin. Atyre u është dhënë mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana e pedagogëve të çdo lënde.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

**Standardi V.6**

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë**

| veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | Institucioni, mbështetur te Statuti UST-së dhe posaçërisht të Rregullore e Organizimit dhe Funksionimit të Administratës, si dhe Rregullore për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët (MVMS, ka hartuar procedura si dhe ka ngritur njësi të posaçme që shërbejnë për informimin e studentëve sipas kërkesave të ligjit. Një rol të qenësishëm luan pa dyshim, Sektori i Këshillimit të karrierës dhe Linku i Alumnit.<br>GVJ, pa konkretisht dokumentacionin, ku pasqyrohet drejtë dhe saktë kjo praktik, në shërbim të informimit të studentëve, në mënyrë institucionale dhe pa pengesa.<br><br>*Ref.24.Alumni (https://alumni.ust.edu.al/)*<br>*Ref.8.7. Rregullore e FVFR, Neni 91, Ankimimi*<br>*Ref 31.Model Pyetsori për Studentin*<br>*Ref 31.2. Vendimi i ngritjes së NJSBC-së*<br>*Ref.31.3.https://ust.edu.al/ëp-content/uploads/2021/05/Manuali NJSBC* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | *Institucioni, mbështetur te Statuti UST-së dhe posaçërisht te* Rregullore e Organizimit dhe Funksionimit të Administratës, si dhe Rregullore për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët (MVMS, ka hartuar procedura si dhe ka ngritur njësi të posaçme që shërbejnë për informimin e studentëve sipas kërkesave të ligjit. Një rol të qenësishëm luan pa dyshim, Sektori i Këshillimit të karrierës dhe Linku i Alumnit, websiti UST-së, nëpërmjet llogarive personale të studentëve, etj.<br>GVJ, pa konkretisht dokumentacionin, ku pasqyrohet drejtë dhe saktë kjo praktik, në shërbim të informimit dhe këshillimit të studentëve të Programit të Studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", asistimin e tyre përgjatë gjithë procesit mësimor akademik, në mënyrë institucionale dhe pa pengesa burokratik.<br><br>*Linku i ALUMNIT (https://alumni.ust.edu.al/)* |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në | Institucioni, mbështetur te Statuti UST-së dhe posaçërisht të "Rregullore e Organizimit dhe Funksionimit të Administratës", si dhe "Rregullore për Mbarëvajtjen e Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët" (MVMS, ka hartuar procedura si dhe ka ngritur njësi të posaçme që shërbejnë për informimin e |

| | |
|---|---|
| mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | studentëve sipas kërkesave të ligjit. Një rol të qenësishëm luan pa dyshim, Sektori i Këshillimit të karrierës dhe Linku i Alumnit, websiti UST-së, nëpërmjet llogarive personale të studentëve, etj.<br>GVJ, pa konkretisht dokumentacionin, ku pasqyrohet drejtë dhe saktë kjo praktik, në shërbim të informimit dhe këshillimit të studentëve të Programit të Studimit Master i Shkencave në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti", në asistimin e tyre përgjatë gjithë procesit mësimor akademik, në mënyrë institucionale dhe pa pengesa burokratike.<br><br>*Linku i ALUMNIT (https://alumni.ust.edu.al/)*<br>*Ref.34.Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale* |
